



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RODNU RAVNOPRAVNOST /
AGENCY OF GENDER EQUALITY

BULETINI INFORMATIV

2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RODNU RAVNOPRAVNOST/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

BULETINI INFORMATIV

2023

01.

INICIATIVAT E AGJENCISË PËR BARAZI GJINORE

Mbahet takimi i rregullt konsultativ “Përkushtimi i Kosovës drejt procesit të Integrimit Evropian nga perspektiva gjinore”

Shënohet 8 Marsi Dita Ndërkombëtare e Gruas

Vazhdohet UA për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve

ABGJ ka mbështetur funksionalizimin e Komitetit të Rrjetit për Fuqizimin e Grave në Pozita Vendimmarrëse në Sektorin

02.

TRAJNIMET DHE SESIONET INFORMUESE TE ABGJ

ABGJ ka mbajtur trajnime me Policinë e Kosovës për PSV

ABGJ ka mbajtur trajnime për MKLKDHF

ABGJ ka mbajtur trajnime për “Parandalimin dhe Trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës

ABGJ ka mbështetur mbajtjen e dy punëtorive për Amendamentimin e LKDHF

ABGJ ka mbajtur punëtorinë “Integrimi gjinor në integrimin në BE”

03.

AKTIVITETET AVOKUESE

25 Nëntor Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas.

Videospotet e realizuara nga ABGJ

Shënohet fushata për parandalimin e kancerit të gjirit

04.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

U zhvillua takim në mes ABGJ dhe Rektorit të UP

Publikohet Plani i Veprimit për Barazi Gjinore për UP

U mbajtur Shkolla Verore mbi Gjininë, Ekonominë dhe Politikën

ABGJ ka realizuar vizita studimore në Gotenburg të Suedisë

Mbahet takimi i rregullt konsultativ “Përkushtimi i Kosovës drejt procesit të Integrimit Evropian nga perspektiva gjinore”

U mbajtur punëtorja ‘Integrimi gjinor në integrimin në BE – sesion fillestar’

Ud. Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ Edi Gusia ka marr pjesë në programin e IVLP “Përgjigjja Institucionale ndaj Dhunës në Familje”

Ud. Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ Edi Gusia ka prezantuar në konferencën “Sfidat dhe mundësitë për Agjendën e Grave, Pages dhe Sigurisë”

05.

AKTIVITETET E ZYRTAREVE PËR BARAZI GJINORE NË MINISTRI DHE KOMUNA



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA

AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RODNU RAVNOPRAVNOST/

AGENCY OF GENDER EQUALITY

FJALIMI I MBAJTUR PARA PËRFAQËSUESVE TË AGJENCISË PËR BARAZI GJINORE TË SUEDISË DHE PËRFAQËSUESVE TË PUSHTETIT LOKAL TË QYTETIT GOTEBORGUT, TETOR 2023.

Shkurtin e kaluar Kosova festoi 15 vjetorin e pavarësisë. Vendi ynë është një demokraci e re, dhe ka ende mjaft hapësirë në zvogëlimin e hendekut gjinor për pjesëmarrjen e grave kosovare në jetën publike dhe politike. Jam e lumtur që jam këtu sot të ndaj me ju rugëtimin dhe përparimin tonë.

Kosova ka një kuadër ligjor të avancuar lidhur me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe barazinë gjinore në veçanti. Neni 22 i Kushtetutës sonë u jep përparësi Konventave të tilla si CEDAW dhe ajo e Stambollit, të cilat mbizotërojnë mbi legjislacionin vendorë edhe përkundër faktit se nuk kemi mundësi ti ratifikojmë.

Në Kosovë kemi të arritura sa i përket përfaqësimit të grave në qeverisjen lokale dhe qendrore. Kemi Presidenten e dytë grua, znj. Vjosa Osmani, një nga politikanët më të votuara ndonjëherë.

2 nga 3 zëvendëskryeministrat janë gra, njëra prej tyre përfaqësuese e minoriteteve. Dhe kuota gjinore ka treguar rezultate të jashtëzakonshme, për herë parë kemi më shumë gra që janë zgjedhur pa nevojën e kuotës. Në zgjedhjet e mëparshme kombëtare, kuota u përdor në fakt, për të siguruar mandatin për një burrë.


Vajzat po arsimohen me një shkallë më të lartë se djemtë. Ka më shumë gra në universitetet tona sesa djem, dhe më shumë prej tyre shkojnë në fusha tradicionalisht të dominuara nga meshkujt si STEM dhe politika.

Gratë po na vendosin në skenën botërore në sport dhe arte.

Kemi tre medalje të arta nga Lojërat Olimpike, në xhudo - një sport për të cilin as që jemi të njohur më parë, dhe të tre medaljet janë fituar nga vajzat tona të fuqishme.

Së fundmi jemi nominuar për Oscar, për një film me regji të një gruaje, i cili tregon historinë e një gruaje të jashtëzakonshme Fahrije Hoti, e cila humbi bashkëshortin e saj në luftën e fundit në Kosovë. Ajo gjeti forcë në pikëllimin e saj dhe ndërtoi një korporatë që shet, dhe madje eksporton 'ajvar', duke u ofruar punësim mbi 200 grave që kanë përjetuar humbje të ngjashme.

Dhe këngëtaret si Rita Ora dhe Dua Lipa janë bërë të njohur në mbarë botën, duke krijuar një vend në hartën e shumë fansave të tyre.



Këto janë vetëm disa nga arritjet tona. Jo keq për një vend 15-vjeçar, dhe ka ende shumë sfida me të cilat përballemi, për të cilat punojmë vazhdimisht për t'i trajtuar.

Pjesa e mirë është se ne kemi investuar shumë në një bazë të fortë ligjore që na mundëson të punojmë për çështjet sfiduese në agjendën e barazisë gjinore.

Së pari, ne kemi Ligjin për barazi gjinore që nga viti 2004, i cili është ndryshuar në vitin 2015. Ky ligj kërkon dhe obligon institucionet publike dhe private, të gjitha nivelet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, që të ndërmarrin hapa për të reduktuar hendekun gjinor në pjesëmarrjen e grave kosovare në jetën publike dhe politike.


Së dyti, kemi Agjencinë për Barazi Gjinore, të cilën unë e përfaqësoj, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Agjencia është njësi qendrore e koordinimit gjinor brenda qeverisë. Është organi më i lartë politikëbërës, monitorues dhe raportues që ka të bëjë me zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, fuqizimin e rolit të grave dhe vajzave dhe agjendën e Kosovës për barazi gjinore në përgjithësi.


Së treti, ne kemi organizata shumë aktive të grave - shoqërisë civile, që përdorin platformat e tyre për të avokuar për barazinë gjinore, dhe punojnë për të adresuar probleme të ndryshme, dhe ne punojmë ngushtë me to në drejtim të avancimit të agjendës së barazisë gjinore.

Sfidat tona vazhdojnë dhe shpesh janë shumë të ndjeshme dhe të vështira. Por, falë këtyre themeleve të forta, ne jemi të sigurt se do ti ja dalim.

Në aspektin ekonomik, gratë janë të nën përfaqësuara në tregun e punës – vetëm 21% e tyre janë aktive në tregun e punës. 64.7% e grave të reja mbetën të papuna, përkundër 51.5% të burrave të rinj. Vetëm 19.18% e pronarëve të pronave janë gra, vetëm 11% e grave kanë biznese; vetëm 3% e kredive tregtare shkojnë për gratë, dhe kjo kryesisht për shkak të mungesës së ushtrimit të së drejtës së trashëgimisë, e cila ndonëse e garantuar me ligj për shkak të normave kulturore, vazhdon t'i pengojë gratë të kërkojnë të drejtën e tyre për pronë. Në arsimin e lartë, pjesëmarrja e vajzave tejkalon atë të djemve, duke shkaktuar fenomenin e grave dhe vajzave të diplomuara për të cilat tregu i punës ka kërkesë të pamjaftueshme.

Kjo vazhdon të jetë një nga sfidat tona më të mëdha, dhe ne po punojmë për ti tejkaluar në disa drejtime: në 2 vitet e fundit, Ministria jonë e Arsimit ka mbështetur vajzat në STEM në shumën prej 2.6 milionë euro, duke u ofruar atyre mundësi për të avancuar në karrierë. Në vitin 2022, për herë të parë, më shumë se 51% e përfituesve të masave aktive të tregut të punës ishin gra.







Ashtu si ju, edhe ne përballemi me raste të dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore. Për shkak të mentalitetit, kjo çështje ka qenë një tabu, duke u trajtuar si çështje e cila duhet të mbetet ‘brenda katër mureve të shtëpisë’. Në vitin 2010, Agjencia për Barazi Gjinore ka hartuar Ligjin e parë për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, dhe një sërë instrumentesh që plotësojnë kuadrin ligjor për mbrojtjen nga dhuna në familje si: Komentari i Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Procedurat Standarde Operative për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, dhe ka përgatitur një kurikulë të trajnimit për zyrtarët që i trajtojnë rastet e dhunës. Qeveria ka miratuar strategjinë e tretë me radhë, për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026, dhe vazhdon financimin e 10 strehimoreve për viktimat e dhunës ndaj grave, dhunës në familje, në baza vjetore. Kemi ende raste që na tronditën deri në palcë, por vazhdojmë të punojmë për të përmirësuar sistemin, për të parandaluar rastet e tilla, dhe për t’i menaxhuar ato në mënyrë efektive kur ato ndodhin.

Për sa i përket ballafaqimit me të kaluarën, dhuna seksuale gjatë luftës ka qenë një sfidë e pabesueshme për t’u përballur, si shoqëri dhe si institucione. Gjatë luftës së Kosovës, një numër i madh grash dhe burrash kanë përjetuar dhunë seksuale, e përdorur nga ushtria serbe si armë lufte. Ne na u desh më shumë se një dekadë për t’u pajtuar me atë që ka ndodhur, dhe për të bërë hapa në drejtim të njohjes statusit të të mbijetuarave/ëve. Një nga arritjet e para të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ABGJ-së në këtë drejtim, ishte hartimi Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325. Arritja më e rëndësishme e kësaj PV ishte se filloi një debat konstruktiv në bashkëpunim me shoqërinë civile. Ky debat i ka paraprirë ndryshimit të Ligjit për viktimat civile, ku kategoria e të mbijetuarve të dhunës seksuale është përfshirë për njohjen e statutit të tyre në këtë ligj si viktimat civile të luftës. Kosova sot ka modelin e saj unik të mbështetjes së këtyre të mbijetuarve, duke ofruar mbështetje psikologjike dhe financiare. Deri më sot, më shumë se 1,500 gra dhe pak burra, të mbijetuar të dhunës seksuale nga lufta e fundit me Serbinë kanë fituar statusin e viktimës civile. Nuk ka asnjë mënyrë reparacioni që mund t’i ngushëllojë ato, ose të zhbëjë atë që ndodhi. Njohja e humbjes së tyre është minimumi i asaj që ne mund të bëjmë, dhe paaftësia jonë për t’i mbrojtur ato dhe për t’u ofruar mbështetje për më shumë se një dekadë, do të jetë përgjithmonë një barrë në ndërgjegjen tonë!

Siç thashë, kemi shumë sfida, por ne vazhdojmë të punojmë për to, dita-ditës.

Që nga viti 2005 Agjencia ka demonstruar leadershipin e saj në mënyrë progresive dhe gjithnjë e më cilësore, duke hartuar dhe zbatuar politika kyçe për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e barazisë gjinore në vend. Ekspertiza profesionale, performanca efektive, leadershipi dhe roli vendimtar në momente të caktuara, janë veçori që Agjencia i ka dëshmuar në këtë rrugëtim gati 18 vjeçar. Për të përkthyer detyrimet e parimeve të barazisë gjinore, kornizat ligjore dhe prioritetet e agjendave të zhvillimit socio-ekonomik të vendit, ABGJ ofron ekspertizën e saj për integrimin e perspektivës gjinore në legjislacion dhe politika publike, harton politika publike dhe strategji sektoriale, punon në zhvillimin e kapaciteteve për arritjen e standardit të barazisë gjinore, etj.





Pavarësisht legjislacionit tonë shumë të avancuar në fushën e barazisë gjinore, zbatimi i tij në shumë fusha mbetet ende shumë sfidues. Por ne gjejmë mënyra! Ne vazhdojmë të fokusohemi në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit duke ndërmarrë veprime afirmative. Për shembull, për të rritur qasjen e grave në pronë dhe për të rritur regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve, ne e kemi bërë procesin pa pagesë deri në prill të vitit 2024. Filluam me 105 çifte në vitin 2016 dhe arritëm në më shumë se 11 000 çifte në total, duke regjistruar pronën në emër të të dy bashkëshortëve deri në fund të vitit 2022 do të vazhdojmë të zhvillojmë politika gjithëpërfshirëse në Kosovë. 2008, dhe tani Programi i ri i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024.

Të gjitha këto arritje do të ishin të pamundura pa bashkëpunimin e organizatave joqeveritare, partnerëve tanë vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët na mbështesin në idetë dhe agjendat koordinuese për qëllimin e përbashkët për realizimin e barazisë gjinore në Kosovë.

Do ta shfrytëzoj këtë rast për të falënderuar mbështetjen shumë bujare të popullit Suedez për mbështetjen e institucioneve tona dhe OJQ-ve. Si institucion, ABGJ përfitoi nga një projekt bujar 4-vjeçar i mbështetur nga SIDA 2016-2020. Falë asistencës së Sida-s, ne kemi prezantuar instrumente moderne të politikave për të siguruar integritimin gjinor në të gjitha nivelet qeveritare si Buxheti i përgjegjshëm gjinore, vlerësimi i ndikimit gjinor GIA, instrumente për të luftuar stereotipet gjinore në arsim, dhe instrumente ex post për kuadrin rregullator të LBGJ.

Për më tepër, ne kemi zhvilluar manuale për të eliminuar stereotipet gjinore në arsim, dhe kemi krijuar partneritete me institucionet e arsimit terciar, duke përfshirë futjen e një lënde të re “Gjinia dhe Ekonomia” në Universitetin e Prishtinës.

Jam krenare për punën e Agjencisë dhe stafit të saj, dhe progresin që ne si vend kemi bërë në vetëm 15 vjet nga shpallja e pavarësisë. Por këto arritje na kanë bërë të etur për më shumë rezultate dhe falë një rrjeti njerëzish që punojnë pa u lodhur për këtë, besoj se do t’ia dalim. Ne do të vazhdojmë të kemi nevojë për mbështetjen tuaj, dhe jemi shumë mirënjohës që e kemi atë. Dhe shpresoj që arritjet e deritanishme të dëshmojnë vlerësimin tonë përmes veprimit dhe të tregojnë se puna për barazinë gjinore në Kosovë është një investim i denjë.

Me respekt,

Edi Gusia

Ud. Drejtore Ekzekutive

Agjencia për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit



MBAHET TAKIMI I RREGULLT KONSULTATIV “PËRKUSHTIMI I KOSOVËS DREJT PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN NGA PERSPEKTIVA GJINORE

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore kanë mbajtur takimin e rregullt konsultativ vjetor të nivelit të lartë, të gjashtin me radhë, me akterë institucional, ekspertë/e dhe përfaqësues/e nga shoqëria civile. Këtë vit takimi u fokusua në përkushtimin e Kosovës drejt procesit të Integrimit Evropian nga perspektiva gjinore. Në Kosovë, ashtu si në vendet tjera të Ballkanit, por edhe më gjerë, avancimi konsolidues i agjendës dhe vlerave të barazisë gjinore, si një e drejtë e pandashme nga të drejtat e njeriut, ka krijuar realitete të reja të demokratizimit politik, ndryshimeve të thella ekonomike, lëkundjeve e zhbërjeve të normave paragjyquese kulturore dhe institucionale, si dhe lindjen e normave të reja të barazisë gjinore.



Angazhimi kryesor në arritjen e barazisë gjinore duhet të fokusohet në zbatimin e ligjeve që - në mënyrë direkte apo indirekte, kanë të bëjnë me barazinë gjinore, por edhe me plotësimin e infrastrukturës së nevojshme. Mirëpo, ndonëse përafrimi i politikave është një proces teknik që duhet të kryhet nga shërbyesit civilë, ai gjithashtu paraqet edhe një agjendë gjithëpërfshirëse të transformimit të shoqërisë dhe shtetit tonë, në mënyrë që të jemi gati t'i gëzojmë privilegjet e anëtarësimit të plotë në BE.

Ud. Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore Edi Gusia, ka thënë se ky takim i përvitshëm, i organizuar me qëllim të thellimit të bashkëpunimit mes aktorëve institucionalë shtetërorë dhe qeveritarë, dhe përfaqësues të shoqërisë civile, fokusohet në angazhimin e Kosovës për Integrim Evropian, ku në fokus ka platformën e integrimit dhe avancimin e agjendës së barazisë gjinore në të gjitha shtyllat e integrimit evropian. Barazia gjinore konsiderohet si një vlerë fundamentale e cila është e rrënjësuar në arkitekturën e ekzistencës së bashkimit evropian, është pjesë e kriterëve që duhen të përmbushen për procesin e përafrimit

me vlerat, parimet kushtet dhe kërkesat e BE nuk mjaftojnë në mënyrë që barazinë gjinore ta bëjmë realitet tonin të përditshëm dhe ti shohim frytet dhe benefitet e saj.

Bashkëpunimi institucional i QRK me shoqërinë civile në zbatimin e agjendës gjinore, përveç se është obligim ligjor i paraparë me rregulloren e punës së Qeverisë, është një përafrim i natyrshëm, i cili buron nga e kaluara historike e aktivizmit të grave kosovare që nga koha e rezistencës.

Ndërkaq Luljeta Demolli, Drejtore ekzekutive në Qendrën Kosovare për Studime Gjinore kërkoi më shumë angazhim nga institucionet për arritjen e barazisë gjinore .

Pjesëmarrës/e në panel ishin Rrezarta Krasniqi, Kryetare e Komisionit për Integrim Evropian, Besnik Bislimi, Zëvendëskryeministër I Parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Arjeta Fejza, Deputete dhe nënkryetare e Komisionit për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të zhdukur dhe peticione të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pjesë e panelit ishin edhe Valmira Rashiti, Zyrtare për Integrim të Perspektivës Gjinore, Rrjeti i Grave të Kosovës si dhe Taulant Hoxha, Drejtor Ekzekutiv, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

SHËNOHET 8 MARSI DITA NDËRKOMBËTARE E GRUAS

Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës Kryeministrit ka shënuar 8 Marsin Ditën Ndërkombëtare të Gruas me dedikimin “Në kujtim të grave krijuese, artiste profesoresha universitare dhe gazetare”, që thyen barrierat në fushat ku vepruan dhe ndërtuan historinë e vendit tonë me fytyrë gruaje, dhe të cilat nuk jetojnë më. Ky shënim 8 Marsi i është dedikuar kujtimit të: Nexhmije Pagarusha, Leze Qena, Sazana Çapriqi, Burbuqe Rushit, Violeta Rexhepagiqi, Burbuqe Berisha, Vjosa Berisha, Arzana Kraja, Alije Vokshi, Edi Shukriu, Esma Mulla, Teuta Tmava, Ardita Sylejmani, Seniha Spahiu, Shahindere Bërlajolli.



ABGJ me këtë rasat ka organizuar 3 panele diskutimi ku folëse kanë qenë gratë krijuese, profesoresha universitare dhe gazetare, të cilat kanë prezantuar eksperiencat personale, pengesat, mbështetjen apo paragjykimet me të cilat janë ballafaquara në zhvillimin e karrierës së tyre.



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti ka thënë se gratë përballen me sfida të shumta, ndërsa nuk trajtohen njëjtë me kolegët dhe shokët e tyre, as pas vdekjes. Ai nder te tjera shtoi se përgjegjësia e barazisë gjinore bie mbi burrat, ndërsa aty u propozua që emrat e grave që ndërtuan historinë e vendit t'iu vendosen institucioneve dhe hapësirave publike.

Kryeministri tha sot se brenda dy vitesh kanë arritur

të përmbushin 18 nga 36 caqet e programeve për barazi gjinore, derisa shtoi se gratë duhet të jenë të pranishme afër nxënësve e studentëve edhe si autore.

E përjetësimi i kujtimit të këtyre grave, sipas Kryeshefes Ekzekutive të Agjencisë për Barazi Gjinore, Edi Gusia bëhet duke u vendosur emrat e tyre institucioneve, shesheve, festivaleve dhe hapësirave publike.

“Agjencia për barazi gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, këtë shënim 8 Marsi ia dedikon grave krijuese, këngëtare, artiste,



aktiviste, profesoresha universitare, gazetares që thyen barrierat në fusha dhe ndërtuan historinë e vendit tonë me fytyrë gruaje... Urojmë që ky takim të na ndihmojë të gjejmë pak kreativitet për të rishikuar historinë e vendit me fytyrë gruaje, duke i bërë këto zonja pjesë të teksteve shkollore, të cilat do të frymëzojnë gjeneratat e reja të vajzave dhe djemve si dhe të përjetësojmë kujtimin e këtyre grave duke i vendosur emrat e tyre institucioneve, shesheve, festivaleve dhe hapësirave publike”.

Po ashtu, një fjalim rasti mbajti edhe Zëvendësministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit Daulina Osmani.

Derisa pjesë e paneli të parë ishin gra nga kultura duke filluar me;

- Lejla Haxhiu Pula- Profesoreshë e Pianos, Fakulteti i Arteve,
- Besa Llugiqi, Soprano,
- Blerta Zeqiri, Regjisore,
- Zake Prevlukaj, Profesoreshë e Pikturës, Fakulteti i Arteve,
- Doruntina Basha, Dramaturge/Skenariste,

Paneli i dytë ishte në përbërje të profesoreshave si:

- Arta Basha Jakupi, Prorektore në Universitetin e Prishtinës
- Vjollca Krasniqi, Profesoreshë e Sociologjisë, Fakulteti Filozofik,
- Majlinda Daci Ajvazi, Profesoreshë e Kimisë, Fakulteti i Shkencave Natyrore,
- Ibadete Bytyqi, Shkencëtare e vitit 2021,
- Ardiana Gashi, Prof. Dr, Fakultet Ekonomik, ligjëruese e lëndës Ekonomiksi Gjinor, si dhe

Paneli i tretë dhe i fundit ishin gazetarët;

- Saranda Ramaj, Gazetare Koha Ditore,
- Kaltrina Rexhepi, Gazetare RTK,
- Gentiana Begolli Pustina, Ish Kryetare e AGK – Gazetare
- Dafina Haliti, Gazetare Kosovo2.0

ABGJ NDRIÇON NDËRTESEN E QEVERISË NË KUJTIM TË GRAVE KRIJUESE, ARTISTE, PROFESORESHA DHE GAZETARE

Agjencia për Barazi Gjinore/ZKM ka ndriçuar Ndërtesën e Qeverisë së Kosovës në shënim të 8 Marsit Ditën Ndërkombëtare të Gruas me dedikimin *“Në kujtim të grave krijuese, artiste profesoresha universitare dhe gazetare”* që thyen barrierat në fushat ku vepruan dhe ndërtuan historinë e vendit tonë me fytyrë gruaje, dhe të cilat nuk jetojnë më. Në ndërtesë u vendosen fotografitë e Nexhmije Pagarusha, Leze Qena, Sazana Çapriqi, Burbuqe Rushit, Violeta Rexhepagiqi, Burbuqe Berisha, Vjosa Berisha, Arzana Kraja, Alije Vokshi, Edi Shukriu, Esmë Mulla, Teuta Tmava, Ardita Sylejmani, Seniha Spahiu, Shahindere Bërlajolli



VAZHDOHET UA PËR REGJISTRIMIN E PRONËS NË EMËR TË DY BASHKËSHORTËVE

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 12/04/2023 ka aprovuar Udhëzimin Administrativ për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy Bashkëshortëve. Prill 2023-Prill 2024.

Përfshirja e grave në pronësinë e pasurive rrit sigurinë e tyre ekonomike dhe kontribuon në rritjen e autonomisë financiare. Regjistrimi i përbashkët i pronave forcon barazinë gjinore në familje dhe në shoqëri duke reflektuar një qasje të drejtë dhe të barabartë në ndarjen e burimeve.

Kjo masë jo vetëm që fuqizon gratë, por edhe kontribuon në ndërtimin e një baze të fortë ekonomike për familjet, duke siguruar më shumë stabilitet dhe përfitime për të gjithë anëtarët.

Vazhdimi i kësaj mase siguron që ndikimi i saj të bëhet pjesë e kulturës dhe praktikave të përditshme, duke ndryshuar mentalitetin dhe strukturat tradicionale. Në vitin 2023 janë regjistruar 5050 prona në emër të dy bashkëshortëve, ndërsa nën total janë 17 592 çifte që kanë pronën në emër të përbashkët.




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/138
Datë: 12.04.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në Emër të dy Bashkëshortëve.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

ABGJ KA MBËSHTETUR FUNKSIONALIZIMIN E KOMITETIT TE RRJETIT PËR FUQIZIMIN E GRAVE NË POZITA VENDIMMARRËSE NË SEKTORIN

Komiteti i Rrjetit për Fuqizimin e Grave në Pozita Vendimmarrëse në Sektorin Publik ka mbajtur takimin e parë- punëtori, me gra udhëheqëse nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

Qëllimi kësaj punëtorie ishte të identifikoj pengesat që mbajnë larg gratë nga vendimmarrja, të mbështes pjesëmarrjen e tyre, duke ndarë eksperiencat, sfidat dhe përvojat e grave që tani me janë në pozita vendimmarrëse:

- Duke ndarë sfidat dhe përvojat për të inkurajuar gratë që të jenë më të guximshme;
- Duke ndarë shkathtësitë dhe njohuritë teknike me njëra-tjetrën për të zhvilluar kapacitetet;
- Duke i mundësuar grave të marrin autoritet dhe përgjegjësi në rolet e tyre, duke marrë vendime të nivelit të lartë;
- Duke motivuar, nxitur, këmbëngulje dhe vetëbesim për të vazhduar zhvillimin e karrierës;
- Duke inkurajuar gratë që të aplikojnë për role më të gjëra dhe drejtuese të nivelit të lartë (proceset e Rekrutimit me Bazë në Meritokraci - RBM).

Organizimi i kësaj punëtorie u financua nga Agjencia për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit, në kuadër të prioritetëve të vendosura në PKBGJ 2020-2023, dhe projekti i rekrutimit për pozitë të larta në Kosovë, zbatuar nga BDO LLP në partneritet me Talogy dhe financuar nga Ambasada Britanike.



ABGJ KA NDERUAR ME MIRËNJOHJE ZBGJ E PENSIONUARA

Agjencia për Barazi Gjinore/ZKM ka mbajt takimin e radhës me Zyrtare për Barazi Gjinore në nivelin lokal dhe qendror si dhe ndau mirënjohje për Zyrtaret për Barazi Gjinore tashme të pensionuara.



Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ Edi Gusia gjatë takimit prezantoi te dalurat nga raporti i monitorimit për zbatimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore. Ndërsa, Shpresa Zariqi Shefe e Divizionit për Bashkëpunim prezantoi Planin e punës së ABGJ për vitin 2023.

Gjatë takimit u diskutuan edhe aktivitetet që do të zhvilloj Agjencia me komunat gjatë vitit 2023 si dhe u dakorduan për iniciimin e një cikli të trajnimeve sipas prioriteteve të vendosura nga PKBGJ.



Agjencia për Barazi Gjinorë ndau mirënjohje për kontributin dhe punën e palodhshme për ish Zyrtaret për Barazi Gjinore tashme të pensionuara te cilat janë: Drita Klaiqi nga Komuna e Gjiilanit, Sanije Mavraj nga Komuna Istogut, Hyka Imeri nga Komuna e Skenderajt, Remzije Maloku nga Komuna e Klinës, Gjyste Dabaj nga Komuna e Lipjanit, Sabahate Qorkadiu nga Komuna e Pejës, Fatime Jasiqi nga MASHT, Kadrije Myrtaj nga MAPL, Zyrafete Murati nga MAP, Nezaqete Rukovci nga MKRS si dhe Asrije Bajgora nga QKUK.

TRAJNIMET DHE PUNËTORITË E MBAJTURA NGA ABGJ

ABGJ ka mbajt trajnime me Policinë e Kosovës për PSV

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kanë mbajtur gjashtë (6) trajnime për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, ku përmes këtij trajnimi policia informohet, orientohet për përgjegjësitë institucionale konform Procedurave Standarde të Veprimit dhe obligimeve të reja që derivojnë nga Konventa e Stambollit për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. Gjatë muajve janar- dhjetor 2023 janë certifikuar 119 polic, prej tyre 85 burra dhe 34 gra në Komunitet: Pejë, Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjiilan





ABGJ ka mbajt trajnime për MKLKDHF

Agjencia për Barazi Gjinore ka mbajt katër (4) trajnime për Mekanizmat Koordinues Lokal kundër dhunë në familje në bashkëpunim me Zyrtar/e për Barazi Gjinore në nivelin lokal, ku janë prezantuar përgjegjësit dhe obligimet për mekanizmin lokal në bazë të prioritetëve të vendosura në SKDHF 2022-2026. Trajnimet u mbajtën në këto komuna: Fushë Kosovë, Deçan,

Vushtrri, Lipjan dhe morën pjesë 72 persona, 46 gra dhe 26 burra.





ABGJ ka mbajt trajnime për “Parandalimin dhe Trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës

Agjencia për Barazi Gjinore/ZKM në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike, në koordinim me Zyrtaret për Barazi Gjinore në nivel qendror dhe lokal, dhe me mbështetje të asistencës teknike të Un Women kanë mbajt trajnim për “Parandalimin dhe Trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës”.

Gjatë trajnimit janë prezantuar temat: format e ngacmimit seksual; politikat kundër ngacmimit seksual në organet e administratës publike; krijimi i një kulture të respektit brenda vendit të punës; zingjiri i menaxhimit të rasteve të ngacmimeve seksuale etj.

Pra, gjatë vitit 2023 janë realizuar 16 trajnime me 375 pjesëmarrës të certifikuar. Prej tyre janë certifikuar 36 Zyrtar/e për Barazi Gjinore (ZBGJ) në Ministri dhe Komuna. Në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor janë certifikuar 112 zyrtarë/e të nivelit udhëheqës dhe menaxherial.

Në nivelin lokal trajnimet janë mbajtur në 11 Komuna: Drenas, Viti, Lipjan, Klinë, Deçan, Obiliq, Dragash, Kamenicë, Skenderaj, Istog, Prizren. Janë certifikuar gjithësejt 227 zyrtarë/e te nivelit udhëheqës dhe menaxherial.







ABGJ ka mbështetur mbajtjen e dy punëtorive për Amendamentimin e Ligjit Kundër Dhunës ndaj Grave dhe dhunës në Familje

Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Viktima të Dhunës Seksuale të Luftës, për Persona të Pagjetur dhe Peticione kanë mbajtur punëtori dy ditore për Amendamentimin e Ligjit kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. ABGJ ka mbështetur këtë proces me ekspertizë dhe financim të punëtorive.



ABGJ ka mbajt punëtorin “Integrimi gjinor në integrimin në BE”

Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar punëtorinë “ Integrimi gjinor në integrimin në BE – sesion fillestar’, e cila u zhvillua në kuadër të Projektit Instrumenti për Barazi Gjinore(Gender Equality Facility) GEF – Reformat e sektorit, strategjitë, programet dhe planet e rimëkëmbjes/zhvillimit pas COVID-19, Kjo punëtori kishte si qëllim informimin dhe njoftimin e pjesëmarrësve me integrimin gjinor në procesin e integrimit në BE. Mbështetur nga UN Women financuar nga Bashkimi Evropian.

AKTIVITETET AVOKUESE

25 Nëntor Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas

Në hapje të fushatë së 16 Ditëve të Aktivizmit, Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj gruas dhe dhunës në baza gjinore Agjencia për Barazi Gjinore/ Zyra e Kryeministrit ka ndriçuar Ndërtesën e Qeverisë me simbolin e kordeles së bardhë dhe ngjyrën portokalli.

Fushata e 16 Ditëve të Aktivizmit është fushatë botërore që organizohet çdo vit. Fushata fillon me 25 Nëntor, dhe përfundon me 10 dhjetor, Ditën Ndërkombëtare për të Drejta të Njeriut.

Çdo vit përmes fushatës bëhen thirrje për veprime globale për të rritur ndërgjegjësimin në mbarë botën për parandalimin dhe eliminimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave.



Përfaqësuesit e Agjencisë për Barazi Gjinore në vazhden e 16 Ditëve të Aktivizmit-Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas ishin për vizitë në Qendrën Korrektuese në Lipjan.



Gjatë takimit, përfaqësuesit e ABGJ patën mundësinë të takohen drejtpërdrejt me gratë e burgosura, të cilat ndodhen në këtë qendër, dhe të dëgjojnë historitë e tyre, duke krijuar një hapësirë për shprehjen e shqetësimeve dhe nevojave të këtyre grave.


Ky takim ishte i rëndësishëm, pasi ofronte mundësinë për të identifikuar sfidat që hasin gratë e burgosura dhe për të adresuar çështje të tilla si shërbimet e rehabilitimit, arsimimi, mbështetja psiko-sociale dhe mundësitë e integritetit të këtyre grave në shoqëri pas përfundimit të dënimit. Një nga temat kryesore të diskutimit ishte forcimi i masave ligjore për mbrojtjen e grave, sidomos për ato që janë viktimë të dhunës, si dhe nënvizimi i rëndësisë së zbatimit të plotë të ligjeve ekzistuese që mbrojnë të drejtat e grave dhe mundësojnë rehabilitimin e atyre që janë përfshirë në sisteme të drejtësisë.

Shënohet fushata për parandalimin e kancerit të gjirit

Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të muajit Tetor, Muaj i Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit ka ndriçuar ndërtesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës me ngjyrën vjollcë dhe kordelen rozë si shenjë solidarizimi me të gjitha gratë që janë prekur nga kanceri i gjirit.

Qëllimi i fushatës është të ndërgjegjohen gratë mbi rëndësinë e zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit dhe masat parandaluese, promovimi i ekzaminimeve dhe vizitave të rregullta mjekësore për të rritur mundësinë e trajtimit të suksesshëm si dhe adresimi i paragjykimave dhe tabuve kulturore që pengojnë gratë të kërkojnë ndihmë mjekësore.

Fushata për ndërgjegjësimin mbi kancerin e gjirit është një thirrje e përbashkët për kujdes shëndetësor dhe mbështetje sociale.



VIDEOSPOTET E REALIZUARA NGA ABGJ

Agjencia për Barazi Gjinore për cdo vit realizon videospote për të informuar publikun mbi barazinë gjinore, dhunën ndaj grave, dhunën në familje, dhunën në baza gjinore, dhe rëndësinë e të qenit të barabartë. Videospotet janë një mënyrë e fuqishme për të ndryshuar qëndrimet dhe sjelljet e njerëzve. Duke përdorur mesazhe pozitive dhe emocionale, ato mund të ndikojnë në individë për të rishikuar perceptimet dhe për të vepruar më përkatësisht në jetën e tyre të përditshme. Përdorimi i mediave sociale dhe platformave të ndryshme mund të sigurojë që mesazhi të arrijë sa më shumë njerëz. Videospotet janë një mjet shumë i rëndësishëm për promovimin e barazisë gjinore, për të pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në shoqëri dhe për të nxitur ndryshime pozitive që mbështesin drejtësinë dhe barazinë për të gjithë.

Videospote 2023 ABGJ ka realizuar pesë videospote vetëdijësuese të cilët janë shfaqur në televizionin publik të Kosovës RTK, KTV-TV 21

- Udhëzimi Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve 2023
<https://www.youtube.com/watch?v=NYuCL7TtB1Y>
- Gratë Krijuese që ndryshuan historinë:
<https://www.youtube.com/watch?v=N6Mk3qQZq78>
- Parandalimin e ngacmimit seksual tek fëmijët
<https://www.youtube.com/watch?v=EqCHdzoEQmY>
- Parandalimi i Dhunës të çiftet adoleshente
<https://youtu.be/8RQ7lcjh7OM> <https://abgj.rks->
- Kosova Nderon kujtimin e Grave të Ndjera Viktima të Dhunës në Familje
<https://youtu.be/kl30-Pv8T1o>

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

U zhvillua takim në mes ABGJ dhe Rektorit të UP

Përfaqësues të Agjencisë për Barazi Gjinore mbajtën takim pune me Rektorin e Universitetit të Prishtinës, prof. dr. Qerim Qerimi, dhe prorektoren prof. dr. Arta Basha-Jakupi

Në këtë takim u diskutua rreth iniciativave që synojnë reduktimin e pabarazive gjinore në fusha të ndryshme të arsimit të lartë, si dhe sfidat me të cilat përballen gratë dhe vajzat në universitet dhe për të identifikuar mundësitë për ndryshime pozitive.



Publikohet Plani i Veprimit për Barazi Gjinore për UP

Agjencia për Barazi Gjinore ka mbështetur Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” së bashku me Un Women, në procesin e hartimit të Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2023/4-2025/6 të Universitetit të Prishtinës.

Plani i Veprimit është një dokument politikash përgjatë tri viteve të ardhshme, gjatë të cilave Universiteti synon të zbatojë veprime dhe projekte, për të reduktuar pabarazitë gjinore. Aktivitetet e planifikuara në dokument synojnë, nga njëra anë, të japin vazhdimësi dhe koherencë ndaj politikave ekzistuese nga universiteti dhe, nga ana tjetër, eksplorimin e veprimeve të reja, për të mbështetur adresimin e pengesave që ekzistojnë ende për barazinë gjinore. Plani i veprimit është aprovuar nga UP.

Plani i Veprimit përmban katër objektiva:

1. Krijimin e kulturës që promovon barazinë gjinore;
2. Arritjen e balancës gjinore në pozita vendimmarrëse/udhëheqëse;
3. Integrimin e perspektivës gjinore në mësimdhënie, punë kërkimore dhe inovacione dhe
4. Parandalimin, mbrojtjen e trajtimin e ngacmimit seksual dhe ngacmimit në universitet.



U mbajt Shkolla Verore mbi Gjininë, Ekonominë dhe Politikat

Me iniciativë të Institutit Kombëtar Demokratik dhe në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore/ZKM me mbështetje të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) nga data 08 -12 shtator është mbajtur Shkolla Verore mbi Gjininë, Ekonominë dhe Politikat.

Shkolla Verore mbi Gjininë, Ekonominë dhe Politikat është program pesë-ditor që ka bashkuar 25-30 studentë dhe liderë të rinj në një mjedis multietnik nga mosha 18 deri në 29 vjeç të interesuar për të ngritur njohuritë rreth gjinisë, ekonomisë dhe politikave duke inkurajuar rrjetëzimin mes pjesëmarrësve me pikëpamje të ndryshme politike. Nëpërmjet ligjëratave, seminareve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit u njohën me konceptet dhe teoritë kryesore të ekonomisë feministe dhe se si gjinia ndikon në sistemet dhe rezultatet ekonomike.

Në njërën nga ditët e Shkollës Verore mbi Gjinin, Ekonominë dhe Politikat në Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka" ishte prezent edhe Kryeministri i Republikës së Kosovës Albin Kurti i cili nën udhëheqjen e panelit nga Ud. Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore Edi Gusia zhvilluan bisedë të hapur me studenteve, të cilët patë mundësinë të dëgjojnë për gjendjen e përgjithshme të barazisë gjinore në vend, për përfshirjen e perspektivës gjinore në politikat e Qeverisë, etj

Gjatë këtyre ditëve u prezantua edhe libri i dytë i përkthyer në gjuhën shqipe me temë "Hyrje e Avancuar e Ekonomiksit Feminist" të autores Joyce Jacobsen si vazhdimësi e bashkëpunimit me Fakultetin Ekonomik.





ABGJ ka realizuar vizita studimore në Gotenburg të Suedisë.

Përfaqësues të Agjencisë për Barazi Gjinore për tri ditë radhazi kanë marr pjesë në punëtorinë e organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore Suedeze në Gotenburg të Suedisë.

Ud. Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ Edi Gusia ka prezantua kornizën ligjore, mekanizmat institucional dhe te arriturat e Qeverisë në agjendën e barazisë gjinore.

Ajo gjatë vizitës përmendi të arriturat e Kosovës në avancimin e barazisë gjinore duke theksuar se Kosova ka një kuadër ligjor të avancuar lidhur me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe barazinë gjinore në veçanti. Neni 22 i Kushtetutës u jep përparësi Konventave të tilla si CEDAW dhe ajo e Stambollit, të cilat mbizotërojnë mbi legjislacionin vendas edhe pse ne nuk i kemi ratifikuar. Është rritur përfaqësimi i grave në pushtetin qendror dhe vendor.

Ajo ndër të tjera ka përmend edhe bashkëpunimin me shoqërinë civile e cila është aktive në adresimin e problemeve të ndryshme.

ABGJ është mirënjohëse shtetit Suedez të cilët për 4 vite radhazi kanë mbështetur ABGJ dhe se kjo vizitë studimore është një vazhdimësi e bashkëpunimit edhe për të ardhmen.





U mbajt punëtorja 'Integrimi gjinor në integrimin në BE – sesion fillestar'

Agjencia për Barazi Gjinore ka mbajt punëtorinë 'Integrimi gjinor në integrimin në BE – sesion fillestar', e cila u zhvillua në kuadër të Projektit Instrumenti për Barazi Gjinore (Gender Equality Facility) GEF – Reformat e sektorit, strategjitë, programet dhe planet e rimëkëmbjes/ zhvillimit pas COVID-19 janë hartuar me ndjeshmëri gjinore në mënyrë të vazhdueshme, të realizuar nga UN Women Zyra në Kosovë, si dhe të financuar nga Bashkimi Evropian.

Kjo punëtori kishte si qëllim informimin dhe njoftimin e pjesëmarrësve me integrimin gjinor në procesin e integrimit në BE dhe harmonizimin e Planit të Veprimit Gjinor të BE-së (GAP III). Ndër



objektivat kryesore është zhvillimi i njohurive, aftësive dhe kapaciteteve të pjesëmarrësve për t'u angazhuar në integrimin gjinor të harmonizuar me BE-në; si dhe identifikimin e nevojave specifike të kapaciteteve të nëpunësve civilë për integrimin gjinor në proceset e integrimit në BE.

Pjesëmarrësit në punëtori ishin nga Zyrtarët nga Agjencia për Barazi Gjinore/ ZKM, Zyra për Koordinim të Bashkëpunimit/ ZKM, Zyra për Planifikim Strategjik/ ZKM, Zyra për Koordinim të Procesit të Stabilizim Asociimit/ ZKM Departamenti për Kriteria Politike/ ZKM, Departamenti Ligjor/ ZKM, Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Zyrtarët për Barazi Gjinore ne nivelin qendror, Stafi përgjegjës nga IBGJ/GEF, UN Women Zyra në Kosovë, si dhe Zyrtarët nga Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, si dhe Departamenti për Përformancë dhe Transparencë të Komunave dhe Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave nga MAPL.

Ud Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ Edi Gusia ka marr pjese në programin e IVLP "Përgjigjja Institucionale ndaj Dhunës në Familje"

Me ftesë të Departamentit të Shtetit të SHBA-së, përmes Programit Ndërkombëtar të Vizitorëve për Leadership (International Visitor Leadership Program IVLP) në Uashington DC, një grup i përfaqësueseve të institucioneve të RKS-së dhe shoqërisë civile ka marr pjesë në programin e IVLP "Përgjigjja Institucionale ndaj Dhunës në Familje".

- Edita ÇANTA, Gjyqtare në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- Leonora KADRIU, Prokurore e Shtetit, Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- Edi GUSIA, Zv. Drejtoreshë Ekzekutive , Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) – Zyra e Kryeministrit (ZKM);
- Fatlume MUSTAFA GASHI, hetuese/polici për dhunën në familje (DHF), Policia e Kosovës (PK);
- Erblina DINARAMA, Drejtoreshë Ekzekutive, OJQ "Shtëpia e Sigurt" - Strehimore për Gratë dhe Fëmijët Viktima të Dhunës në Familje.

Përmes pjesëmarrjes në këtë program synohet të përvetësohet eksperiencia e ndërveprimit ndërinstitucional, shumë-sektorial për të trajtuar me efikasitet rastet e dhunës në familje. Do të shqyrtohen praktikat më të mira të SHBA-së në nivel federal, shtetëror dhe lokal në ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të dhunës në familje, duke u fokusuar kryesisht në qasjen e përqendruar në viktimën.

Mes shumë takimesh, ndër me të rëndësishmet, veçojmë takimet me Përfaqësues të Këshillit të Politikave Gjinore /Departamenti i Shtetit; Zyrën e Çështjeve Globale për Gratë dhe Byronë e Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe të Punës. Është realizuar takim me znj Catherine M. Poston-Departamenti i Shtetit /Drejtësisë- Zyra për Dhunën ndaj Grave; znj Nicole McClain Walton - Këshilli Mbikëqyrës dhe Hetimor i Komitetit të Senatit për Legjislacion; znj Pragna Soni-OPDAT.



***Ud. Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ Edi Gusia ka prezantuan në konferencën
“Sfidat dhe mundësitë për Agjendën e Grave, Paqes dhe Sigurisë”***

Rezoluta 1325 e Sigurisë së OKB-së njihë rolin vendimtar që luajnë gratë në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, si dhe në ndërtimin e paqes dhe rindërtimin pas konfliktit. Së bashku me Deklaratën e Pekinit dhe Platforma e saj për Veprim, ajo përfaqëson një moment historik për përparimin e të drejtave të grave. Megjithatë, progresi në zbatimin e Rezolutës 1325 të KS të OKB-së dhe rezolutave të tjera të KS të OKB-së, përfaqësimi i agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë ka qenë i ngadaltë.

Ud. Drejtoresha Ekzekutive e ABGJ-së ka marr pjesë në konferencën ndërkombëtare me ftesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Sllovenisë dhe Norvegjisë, Sfidat dhe mundësitë për Agjendën e Grave, Paqes dhe Sigurisë – Perspektiva nga Europa Juglindore dhe Ukraina dhe ka prezantua për të arriturat në integrimin gjinor në fondet e rimëkëmbjes ekonomike Covid 19, mbështetjen e vazhdueshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës për procesin e verifikimit të statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, sfidat dhe mundësitë e agjendës së barazisë gjinore në Kosovë.



AKTIVITETET E ZYRTAREVE PËR BARAZI GJINORE NË MINISTRI DHE KOMUNA

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë: ka realizuar aktivitete të shumta në zbatim të planit të punës, PKBGJ-së, Planit të Veprimit kundër dhunës në familje dhe Planit të veprimit kundër trafikimit. MASHT gjatë vitit ka hartuar dhe prezantuar doracakun për mësimdhënës dhe profesionistët e arsimit për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi.

Organizimi i takimeve me nxënës për rolin e arsimit në parandalim të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. U prezantuan edhe dokumentet e hartuara nga MASHTI për rolin e shkollës në parandalim të këtyre dukurive. Pjesmarrës në këto punëtori ishin Ministria e MASHT znj. Arëberie Nagavci, Ministria e ME znj. Artane Rizvanolli si dhe Ministria e MD znj. Albulena Haxhiu.

ZBGj ka organizuar sesione informuese me mësimdhënës të komunës së Gjilanit për parandalimin e ngacmimeve seksuale. Organizimi i sesionit informues me prindër të komunitetit romë, ashkali dhe egjiptjan të komunës së Gjakovës për masat e parandalimit, raportimit të martesave të herëshme.



Gjatë “16 Ditëve të Aktivizmit” MASHT ka prezantuar Informatorin për staf shkollor rreth zbatimit të Konventës së Stambollit, janë organizuar edhe aktivitete me nxënës të SHMU “Naim Frashër” në Prishtinë me temë” Ndërgjegjësimi i nxënësve për dhunën digjitale, pjesmarrës kanë qenë 38 nxënës, 18 vajza dhe 20 djemë. Aktivitet si ky është realizuar edhe në SHMU “Pavarësia “ në Prishtinë, “Xhemajl Mustafa” dhe “Xhevdet Doda” në Prishtinë. Numri total që ishin përfitues të këtyre sesioneve ishin 176 nxënës. 84vajza ishin dhe dhe 92 djem. Këto punëtori u realizuan me mbështetje të Këshillit të Evropës.

- MASHT gjatë vitit 2023 ka përkrahur 1882 studentë vajza/gra të regjistruara për herë të parë në programet e studimit STEM dhe student të cilat kanë përfunduar vitin e parë dhe të dytë të studimeve me nga 1.000 euro. Shuma totale e pagesës është 1.882.000 euro;
- MASHT gjatë vitit 2023 ka përkrahur 1647 studentë të niveli bachelor dhe me notë mesatare 9 me nga 1 mijë euro. Shuma totale e pagesës është 1.647.000 euro;
- MASHT gjatë vitit 2023 ka përkrahur 28 studentë me aftësi të kufizuar me nga 1 mijë euro. Shuma totale e pagesës ka qenë 28.000 euro;
- MASHT gjatë vitit 2023 ka përkrahur 55 studentë të komunitetit rome, ashkali dhe egjiptian me nga 1 mijë euro. Shuma totale e pagesës ka qenë 55.000 euro;
- MASHT gjatë vitit 2023 ka përkrahur 70 studentë me bursa në drejtimet deficitare dhe drejtimet teknike me nga 500 euro për një vit shkollor. Shuma totale e pagesës ka qenë 35.000;
- MASHT gjatë vitit 2023 ka përkrahur 13 përfitues të bursave të niveli master në top 150 universitetet më të mira në botë sipas listës Shanghai 2023. Përfituan nga 7 mijë euro. Shuma totale e pagesës ka qenë 91.000;
- MASHT gjatë vitit 2023 ka përkrahur 43 studentë të cilët ndjekun studimet e doktoratës në 500 universitetet më të mira në botë sipas listës Shanghai 2023 nga 8.500 euro. Shuma totale e pagesës ka qenë 365.500 euro.;
- MASHT gjatë vitit 2023 ka përkrahur 467 nxënës të shkollave të mesme të larta nga komuniteti romë, ashkali dhe egjiptian me nga 300 euro. Shuma totale e pagesës ka qenë 140.100 euro;
- MASHT gjatë vitit 2023 ka përkrahur 89 nxënës të Gjimnazit të specializuar matematikor në Prishtinë për vitin shkollor 2023/2024 me nga 1 mijë euro. Shuma totale e pagesës ka qenë 89.000

ZBGJ ka mbajtur tri punëtori me mësimdhënës të komunës së Prishtinës, Gjilanit dhe Ferizajt për parandalimin e ngacmimeve seksuale përmes programeve mësimore si dhe mënyrën e raportimit në rastet eventuale. Pjesmarrës në këto punëtori ishin 118 mësimdhënës, 77 prej tyre ishin mësimdhënësë gra dhe 41 mësimdhënës burra

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë: ka realizuar aktivitete te parapara sipas planit të punës, në fuqizimin e barazisë gjinore, parandalimin e dhunës në baza gjinore, dhunës në familje, dhe dhunës ndaj grave. ZBGJ me mbështetjen e Njësins Koordinuese, Projekt Emergjent i Kosovës ndaj COVID '19 të Bankës Botërore, brenda MSh-së ka mbajtur tryezë të rrumbullakët me të gjitha institucionet kyqe sipas legjislacionit të tri nivelet e kujdesit shëndetësor për t'u paisur me njohuri për identifikim, trajtim, referim dhe regjistrim të mbijetuarave të dhunës në bazë gjinore, dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave me pjesëmarrje të gjerë të institucioneve kyqe: drejtor shëndetësor, përfaqësues të institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor, përfaqësues nga Sherbimi Spitalor Klinik Univerzitar, QKUK, Emergjences, Psikiatrisë, Gjinekologjisë, përfaqësues nga ABGJ si dhe përfaqësues nga Policia e RKS, Spitalet regjionale, Instituti i Psikiatrisë Forenzike të RKS, Mbrojtës të mbijetuarave të dhunës ndaj grave dhe vajzave. Nga kjo tryezë dolën rekomandimet nga profesionistët shëndetësor që ka nevojë për vazhdimin e trajnimeve për dhunën në bazë gjinore në identifikim, trajtim, referim, dhe regjistrim në formular të veçantë të mbijetuarat e dhunës në familje. Janë mbajtur trajnime në shtatë regjione të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjiilan dhe Gjakovë, kanë marrë pjesë stafi profesionist shëndetësor i angazhuar në kuadër të Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare.

Në trajnim nga shtatë regjione kanë marrë pjesë: 50 mjeke dhe 36 mjek, 53 infermjere, 14 infermjere, gjithsej 155, ku janë trajnuar dhe akredituar nga OMK mjekë me nga 11 pike kurse infermjere nga 10 pike. Në gjashtë muorin e parë janë iniciuar dhe realizuar trajnime nga Ministria e Shëndetësisë/ZBGJ me akter kyq në bashkëpunim AMC dhe UNFPA janë mbajtur trajnime dy ditore për dhunën në bazë gjinore me profesionistët shëndetësor, ku pjesëmarrës kanë qenë (44 mjek dhe infermjer) nga dhjetë komuna të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i tryezës ishte që palët e interesit të bashkëpunojnë që nga raportimi i dhunës, bashkëpunimi nderinstitucional, deri te adresimi i rastve të dhunës në familje. Janë trajnuar dhe çertifikuar në total 46 profesionist shëndetësor në regjionin e RKS ZBGJ në MSH-së në bashkëpunim Aksioni për Nena dhe Femijë (AMC) implementues, në mbështetje të UNFPA në muajin Mars janë mbajtur tri trajnime me temat: Programi Orientues mbi Shëndetin e Adoleshenteve (trajnim 4 ditore). Në trajnim morën pjesë: 23 pjesëmarrës profesionist shëndetësor (9 mjekë dhe 12 infermjere në regjion; Etika Profesionale dhe të Drejtat e Pacienteve (trajnim 1 ditore) në trajnim morën pjesë: 17 pjesëmarrës (9 mjekë dhe 8 infermjere); Shëndeti Seksual dhe Riprodhues i Përsoneve me nevoja të veçanta (trajnim 2 ditore) në trajnim SHSRPNV morën pjesë 17 pjesëmarrës (7 mjek dhe 10 infermjere) regjionale gjitha trajnimet janë të akreditura në Oden e Mjekëve të Kosovës dhe në Oden e Infermierëve të Kosovës. Trajnim dy ditore për dhunën në bazë gjinore me profesionistët shëndetësor, ku pjesëmarrës kanë qenë (16 mjek dhe infermjer) nga dhjetë komuna të Republikës së Kosovës. Nga trajnimi 65 profesionist shëndetësor u trajnuar dhe u çertifikuan nga Oda e Mjekëve dhe Infermierëve të Republikës së Kosovës për dhunën në bazë gjinore, dhunën në familje.

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim AMC dhe UNFPA kanë mbajtur dy trajnim: Dhuna në bazë gjinore ku janë trajnuar 17 persona (9 mjek/e dhe 8 Infermier) prej tyre 14 gra dhe 3 burra; Shëndeti Seksual Riprodhues i Përsonave më Aftësi të Kufizuar janë trajnuar 13 profesionist shëndetësor (4 mjek dhe 9 Infermier) prej tyre 8 gra dhe 5 burra; Për vitin 2023 nga trajnimet MSH me DKPSH të implementuar dhe mbështetur nga AMC janë organizuar 9 trajnime dhe janë trajnuar gjithësej: 112 profesionistë shëndetësor.

MSH me mbështetje të Projektit Emergjent të Kosovës ndaj COVID 19- 2023, ka vazhduar sipas planit të punës me tryezë e rrumbullakët, me pjesëmarrje të gjerë: drejtor shëndetësor Drejtorë/përfaqësues të institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH)/ Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF-ve), përfaqësues nga QKUK-Drejtori Emergjences, drejtorë e Klinikave Psikiatrike, drejtorët e Klinikave të Gjinekologjike, përfaqësues nga ABGJ si dhe përfaqësues nga Policia e RKS, Spitalet regjionale-drejtorët e Spitaleve, QSHM, Instituti I Psikiatrisë Forenzike të RKS, Mbrojtës të mbijetuarave të dhunës ndaj grave dhe vajzave, dhe me trajnimin për identifikim, trajtim, referim dhe raportim të mbijetuarave të dhunës në bazë gjinore, dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave me të gjithë akterët kyq në tri regjione: Mitrovicë, Pejë dhe Gjilan. Gjithësej në tri regjionet e RKS pjesëmarrës ishin 94, ku të gjithë pjesëmarrësit janë akredituar nga Oda e Mjekëve të Kosovës me nga 11 pikë dhe Oda e Infermierëve të Kosovës me nga 10 pikë.



Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal: ka raportuar bazuar në planin e punës për vitin 2023, duke theksuar angazhimin e saj në zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar dhe avancimin e barazisë gjinore.

Gjatë vitit, MZHR ka implementuar tre programe kryesore:

- Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB), ku kanë përfituar 132 projekte, prej të cilave 45 janë udhëhequr nga gra;
- Programi për Zhvillim Rajonal (PZHR), ku përfituan 21 projekte nga 20 komuna;
- Programi për Mbështetje Financiare të OJQ-ve, me 45 projekte përfituese, përfshirë 14 gra dhe 31 burra.

Në kuadër të aktiviteteve të Ministrisë, janë organizuar trajnime për fuqizimin e grave në ekonomi, si “Roli i shoqatave të grave në stimulimin e ndërmarrësisë” dhe “Përgatitja e Gruas për tregun e punës.”

Gjithashtu, Ministria ka hartuar dokumente strategjike për zhvillimin rajonal dhe ka respektuar standardet e barazisë gjinore në proceset vendimmarrëse. Këto përpjekje reflektojnë përkushtimin e MZHR-së për të ndërtuar një ekonomi të qëndrueshme dhe përfshirëse në Kosovë.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Komunitetit dhe Kthimit: ka raportuar rreth masave për mbështetje financiare për burra dhe gra të kthyer, nga kategoria e subvencioneve nga 95 sa janë ndarë, kanë përfituar 29 gra, mbështetja u ofrua në shërbime shëndetësore, ushqim dhe higjienë, ndihmë në zhvillim ekonomik bujqësor, pajisje shetpiake etj.

- Nga Programi për Ringjallje Ekonomike në bujqësi nga 102 subvencione sa janë ndarë në shumë 1.046,140.41€, kanë përfituar 16 gra në shumën prej 182,160€;
- Nga Programi për Ringjallje Ekonomike për OJQ, janë mbështetur 57 OJQA në shumë totale 928, 745.25€, nga këto kanë përfituar 10 burra në shumën 180 015€, ndërsa 47 gra, në shumën 748 730,25€;
- Nga Programi për Ringjallje Ekonomike për përkrahjen e ekonomive të vogla familjare kanë përfituar gjithësejtë 101 familje, në shumën totale 1,014,974,97€, ndërsa përfitueset kanë qenë 26 gra, në shumën totale prej 245, 924.94€.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Minsitrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural: gjatë vitit 2023 ka realizuar vizita në kuvendet komunale, ku u takuan me këshilltaret komunal dhe fermerët e komunave përkatëse për ti njoftuar me procedurat për aplikim për grante dhe subvencione të cilat i ndan MBPZHR.

ZBGJ ka qenë pjesë e grupeve punues për hartimin e projekt rregullores dhe concept dokumenteve si: Anëtare në grupin punues, për Projekt rregulloren për caktimin e metodave të vlerësimit të pronave të MBPZHR-se”; Anëtare ne grupin punues, për hartimin e Projekt Koncept Dokumentit për peshkatari dhe akuakulture”; Anëtare ne grupin punues, për hartimin e “ Projekt Koncept Dokumentit për Produkte për Mbrojtjen e Bimeve”; Anetare ne grupin punues për hartimin e Koncept Dokumentit për Farerat; Anëtare ne grupin punues për hartimin e Ligjit për Faturat e Kulturave Bujqësore dhe Fletëmagazinave. Anetare ne grupin punues për hartimin e koncept dokumentit për Kooperativat Bujqësore.

ZBGJ në bashkëpunim me organizatën CNVP kanë realizuar vizitë studimore në Unionin e Grave të Hungarisë në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Grave Rurale, vizita po ashtu kishte për qëllim krijimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit të institucioneve publike.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës: gjatë vitit 2023 ka zhvilluar aktivitete konform planit dhe strategjisë së veprimit, në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të parapara me legjislacionin në fuqi, pjesëmarrjen në takime të ndryshme, raportimet periodike, si dhe në ndërmarrjen e aktiviteteve të tjera shtesë, të cilat kanë rezultuar si nevojë e zhvillimeve dhe veprimeve të dala nga kërkesat që i ka parashtruar situata e krijuar. Konform Ligjit për Barazi Gjinore, Ligjit Kundër Diskriminimit, Konventës CEDAW dhe Programit të Kosovës për arritjen e barazisë gjinore, ZBGJ është fokusuar në monitorimin dhe vlerësimin e krijimin e mundësive për implementimin e këtyre strategjive dhe dokumenteve për arritjen sa me të mirë të standardeve që promovojnë barazinë gjinore në MMPHI-ës.

Në shënim të 8 Marsit Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ZBGJ ka marr iniciativën me mbështetje të Njesisë për Patent shofer në Ferizaj, për tetë (8) gratë e para të cilat kanë paraqesit provimin për Patent Shofer të lirohen nga pagesa, me qëllim të inkurajimit të grave për të aplikuar dhe për tu pajisur me patentë shofer.

Në përkrahje për të gjitha gratë e prekura nga kanceri gjirit, stafi I MMPHI është mbledhur bashkarisht për të diskutuar dhe për të përcjell mesazh vetedijuesues për rëndësinë kontrollit dhe zbulimit të hershëm për kancerin e gjirit.

Sa i përket të dhënave të punësuarve në MMPHI është si vijon: 238, nga të cilët 173 burra ose 73,00%, kurse 65 gra ose 27,00%. Statistikat nga Divizioni i financave



të Mnisitrisë për vitin 2023 të dhënat e ndara sipas gjinive, që kanë udhëtuar zyrtarisht, 29 burra ku morën pjesë 72 herë- 94.74% në udhëtime zyrtare, kurse nga 13 gramorën pjesë 24 herë - 05.26% në udhëtime zyrtare. Raporti i statistikave për aksidentet e vitit 2023 nga Policia e Kosovës, të ndara sipas gjinive, vdekshmëria në aksidente fatale: janë 23 gra dhe 82 burra.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës: ka realizuar aktivitete bazuar në planin e punës, të parapara gjatë vitit 2023. Në bashkë organizim me SKAT programi IWRM-K, kanë organizuar takime publike për hartimin e koncept dokumentit të fushës së ujërave në “ Ditën Ndërkombëtare të Ujërave” me pjesëmarrës nga komunat dhe OJQ-të. Aktiviteti është mbështetur nga programi SKAT programi IWRM-K.

MMPHI në bashkëpunim me MASHT, IKSHIP-MSH dhe DKA-të kanë organizuar ligjërata për “Ditën Ndërkombëtare të Ujërave” në SHFMU-të në nivel vendi.

Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Meteorologjisë MMPHI ka organizuar vizitë të shkurtër laboratorit me rreth 50 nxënës të SHFMU-së “Iliria” në Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës. Në shënim të “Ditës Botërore të Tokës” MMPHI në bashkëpunim Zyrën e Presidencës, Komunën e Prishtinës, UNDP-në, Ambasadën e Luksemburgut, Ambasadën Japoneze, USAID dhe shumë partnerë zhvillimorë ka shënuar aktivitete sipas agjendes dhe aktivitete me fëmijë ku fëmijët kanë ndërtuar një kënd lojërash nga plastika njëpërdorimshe në sheshin “Skënderbe”. Aktiviteti është financuar nga UNDP.

ZBGJ në bashkëpunim me ABGJ kanë organizuar punëtori dy ditore me temë “Kontributi i Grave në mbrojtjen e resurseve ujore dhe përfshirja e barabartë gjinore” përkrahur nga Programi i Menagjimit të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë. Te kuptuarit e roleve, përgjegjësi, përparësi dhe nevojave të ndryshme thelbësore për çdo projekt në lidhje me menagjimin e ujërave.

ZBGJ ka kontribuar në hartimin e politikave të Ministrisë lidhur me nevojat e ndryshme të grave dhe burrave gjatë: Rishikimit të Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë – SMIMK (2021-2030), Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm, Strategjisë së Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor, Projekt Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Strategjisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm 2024-2033

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Ekonomisë: ka raportuar lidhur me përfaqësim gjinor dhe përmirësimin e barazisë gjinore në të gjitha nivelet e aktiviteteve dhe iniciativave të saj gjatë vitit 2023.

Ministria e Ekonomisë gjatë vitit 2023 ka organizuar tryezë të rrumbullakët për barazinë gjinore në sektorin e energjisë në Kosovë, duke përfshirë palët e interesit si KEK, KOSTT dhe ZRrE, të cilat janë pjesë e programit për integrim intensiv gjinor të udhëhequr nga projekti Engendering Industries (EI). Programi Engendering Industries i financuar nga USAID, mbështet udhëheqësit e institucioneve në zbatimin e planit për barazi gjinore përmes trajnimeve dhe mentorimit.



Ministria e Ekonomisë gjatë vitit 2023 ne Projektin KODE, përmes Programit YOU ka financuar trajnimet në fushën e TIK-ut për të rinjtë e Kosovës. Në kuadër të këtij programi janë trajnuar 1200 përfitues në më shumë se 14 programe të ndryshme teknike. Sa i përket përfshirjes gjinore, deri me tani 41% të përfituesve janë gra ndërsa 59% burra. Vlen të theksohet që në disa programe që kërkohet më shumë kreativitet si Marketing Dixhital, pjesëmarrja e grave kalon në 60%. Programet trajnuese janë duke u zhvilluar në shtatë (7) rajonet e Kosovës për modulet teknike profesionale si: Administrator i rrjetave, Zhvillues i aplikacioneve mobile IOS dhe Android, Zhvillues Full stack, Video Editing, React Java Script Developer, Amazon Web Services AWS Linux, Azure cloud dhe Linux, ERP Business Solutions, Cyber Security, etj., të kombinuara edhe me shkathtësitë e buta për secilin modul.

Së paku edhe 800 të rinj tjerë përfitues nga këto trajnime deri në fund të vitit 2024, përveç orëve trajnuese teknike dhe shkathtësive të buta, poashtu përfitojnë edhe orë shtesë mentorimi e konsulence për ti mbështetur ata për tu kyçur në tregun e punës.

Ministria e Ekonomisë gjatë vitit 2023 ka hapur Thirrjen publike për mbështetjen e konsumatorëve familjarë në investimin e pajisjeve eficiente për ngrohje; Pajisjeve shtëpiake eficientet, Pompë termike, Kondicioner, Klimë eficiente (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efizienz të lartë), Kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket); Stufa individuale me biomasë si dhe për mbështetjen e ndërmarjeve mikro të vogla dhe të mesme (NMVM), në investimin në pajisje eficiente për ngrohje.

Thirrjen për subvencionim me Pompë termike, Kondicioner, klimë eficiente (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efizienz të lartë), Ministria e Ekonomisë ka ofruar masa lehtësuese për disa kategori të cilat kanë nevojë për përkrahje dhe mbështetje, pra për prindërit vetëushqyes gjashtëdhjetë përqind (60%) e vlerës investive, për qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II) është subvencionuar gjashtëdhjetë përqind (60%) e vlerës investive. Kurse për Stufa individuale me biomasë, për prindërit vetëushqyes janë

subvencionuar nëntëdhjetë përqind (90%) e vlerës investive, për qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II) janë subvencionuar nëntëdhjetë përqind (90%) e vlerës investive.

Thirrja publike për subvencionimin e Ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme (NMVM), në investimin në pajisje eficiente për ngrohje, shqyrtimi i aplikuseve është duke vazhduar edhe gjatë këtij viti, ku deri me tani kanë përfituar 20 aplikues në kategorinë e klimave, ku nga këta 20 përfitues, 3 prej tyre janë gra, të cilat gëzojnë të drejtën e përfitimit në përqindje, 5%. Pra për bizneset në pronësi apo në bashkëpronësi të grave nga pesëdhjetë e një për qind (51%) e tutje, vlera e subvencionimit është njëzet e pesë për qind (25%). Përfitues total të gjitha masave gjithsejtë është 11454 aplikues, ku prej tyre 2510 apo 22% janë gra dhe 8944 apo 78% burra.

Në thirrjen publike të mbështetjes së konsumatorëve familjarë në investimin e pajisjeve shtëpiake eficiente, gjithsejtë kanë qenë 3550 përfitues, ku prej tyre 1009 apo 28% janë gra dhe 2541 apo 72% janë meshkuj, kategori sociale gjithsejtë janë 134 përfitues, ku prej tyre 82 janë femra dhe 52 burra. Ndërkaq, prindër vetushqyes gjithsej janë 42 përfitues, ku prej tyre 31 janë gra dhe 11 burra. Kurse komuniteti jo shumice gjithsejtë janë 81 përfitues, ku prej tyre 25 gra dhe 56 burra.

Në thirrjen publike për mbështetjen e konsumatorëve familjarë në investimin e pajisjeve eficiente për ngrohje; Kondicioner, klimë eficiente (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efikasitet të lartë, ende janë duke u shqyrtuar aplikacionet. Gjithsej kanë qenë 4533 përfitues, ku prej tyre 948 apo 21% femra dhe 3585 apo 79% meshkuj. Kategori sociale gjithsej janë 31 përfitues ku prindër vetushqyes janë 19 përfitues, ndërkaq prej tyre 13 janë femra dhe 6 meshkuj.

Në thirrjen publike për mbështetjen e konsumatorëve familjarë në investimin e pajisjeve eficiente për ngrohje; Pompë Termike, kanë qenë 1460 përfitues, ku prej tyre 186 apo 13% gra dhe 1274 apo 87% burra.

Në thirrjen publike të Kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket); gjithsej kanë qenë 891 përfitues ku prej tyre 95 apo 11% gra dhe 796 apo 89% burra. Kurse të Stufa individuale me biomasë gjithsej kanë qenë 1020 përfitues ku prej tyre 272 apo 27% gra dhe 748 apo 89% burra. Kategori sociale gjithsejtë 55 përfitues 19 gra ndërsa 36 burra dhe prindër vetushqyes gjithsejtë 15 përfitues, 10 gra dhe 5 burra.

Gjatë vitit 2023 përfaqësimi gjinor në bord të NP ka qenë 35% gra dhe 65% burra. Përfshirja e strukturës gjinore në Bord të 18 Ndërmarrjeve Publike; Telekom i Kosovës 57% gra dhe 43% burra, Iber Lepenci 28% gra dhe 72% burra, KRU Mitrovica 25% gra dhe 75 burra, NP.KEK 33% gra dhe 67% burra, KMDK 40% gra dhe 60 burra, KRU.Hidromorava 42% gra dhe 58% burra, KRU.Hidrodrini 20% gra dhe 80% burra, KRU.Gjakova 50% gra dhe 50% burra, NP. InfraKos 40% gra dhe 60%, NP. Trainkos 0% gra dhe 100% burra KRU.Bifurkacioni 40% gra dhe 60% burra, KRU.Hidroregjioni Jugor 14% gra 86 burra, NP. Trepça 40% gra dhe 60% burra, KRU.Prishtina 60% gra dhe 40% burra, Posta e Kosovës 57% gra 42 burra KUR.Radoniqi Dukagjini 0% gra dhe 100%, NKEC 66% gra dhe 34% burra dhe KRU Drini 0% gra dhe 100% burra.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Prishtinës: ka prezantuar raportin e saj vjetor për vitin 2023, duke shpalosur një sërë aktivitete të realizuara për të promovuar barazinë gjinore dhe për të luftuar dhunën në familje.

Raporti përfshin organizime, trajnime dhe fushata që synojnë fuqizimin e grave dhe vajzave, si dhe përfshirjen më të madhe të komunitetit në këto çështje jetike. ZBGJ si pjesë e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje, kanë diskutuar për Planin e Punës 2023 dhe hartimi i rregullores për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore. Në bashkëpunim me Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve dhe me mbështetjen e Rrjetit të Grave të Kosovës, përmes fondeve të siguruara nga UN Women Kosova, është organizuar një trajnim njëditor për Mekanizmin Koordinues Komunal për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Trajnimi u fokusua në zbatimin e Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, i lansuar më 5 dhjetor 2022 nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore. Gjatë trajnimit u diskutuan edhe sfidat që hasen gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje, duke u fokusuar në përmirësimin e qasjes institucionale ndaj këtyre rasteve. Në bashkëpunim me Shoqatën e Grave në Sektorin e Energjisë në Kosovë (AWESK), u mbajt një ligjëratë informuese nga gra profesioniste të sektorit të energjisë, dedikuar grave të Komunës së Prishtinës. Në Ditën Ndërkombëtare të Vajzave, ZBGJ së bashku me Asamblenë e Fëmijëve të Kryeqytetit, vizitoi Kompaninë Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike (KEDS), duke inkurajuar vajzat të ndjekin pasionet e tyre pa u ndikuar nga stereotipet. Në tetor u zhvillua fushata “Tetori – Muaji Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore”, me aktivitete të shumta ndërgjegjëse në shkolla dhe komunitet.



Hapja e fushatës “16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, me moton “Kryeqyteti me ju – SOT DHE ÇDO DITË TJETËR”, përfshiu ligjërata, ekspozita dhe mesazhe sensibilizuese për qytetarët dhe institucionet. Në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), u mbajt një tryezë që adresoi kërcënimet dhe sfidat me të cilat përballen gratë në sektorin e

sigurisë dhe dhunën me bazë gjinore. Në shënim të 8 Marsit Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ZBGJ në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, u organizua aktiviteti vetëdijësues me moton “**Super çikat e Prishtinës**”, i cili synonte promovimin e fuqizimit të grave dhe vajzave, si dhe thyerjen e stereotipeve shoqërore. Aktivitet u udhëheqë nga Verda Muqaj, Kryetare e Asamblesë së Fëmijëve në Prishtinë, ndersa një fjalë rasti mbajti Kryetari i Kryeqytetit z. Përparim Rama dhe nxënësit që dëgjuan tregimet personale të grave si Togere Ilirjana Bunjaku programere –Zana Tabaku, kapitene policie Begishje Krasniqi, alpiniste Mrika Nikçi, shofere autobusi Laura Mirena dhe nënkryetare e Kryeqytetit z. SahatçiuKy aktivitet i veçantë inkurajoi të rinjtë që të ndjekin ëndrrat e tyre pa u ndikuar nga paragjykimet dhe kufizimet shoqërore.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Vushtrrisë: gjatë vitit kalendarik, ka marrë pjesë dhe ka organizuar aktivitete të shumta në bashkëpunim me institucione dhe organizata të ndryshme, me qëllim promovimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut. ZBGJ ka marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit Komunal, dhe të Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi (KKSB), Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje dhe Komisionit Komunal për Riatdhesim. ZBGJ ka mbajtur takime me grupin joformal të grave të IADK, ku u diskutua për bashkëpunimin dhe fuqizimin ekonomik të grave (80 pjesëmarrëse në 4 takime).

Hapja e fushatës "Tetori, Muaji i Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit," përmes aktiviteteve si marshime, ligjërata dhe ekspozita (60 pjesëmarrës, 30 gra). Ligjërata edukative kundër SIDA-s në shkollë (rreth 50 nxënës). Aktivitetet për Ditën Ndërkombëtare të Vajzave dhe Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë, me pjesëmarrjen e nxënësve dhe mësuesve për promovimin e të drejtave të vajzave dhe zhvillimin demokratik. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë janë mbajtur takime për promovimin e përfshirjes së grave në bujqësi dhe subvencionimin e grave kryefamiljare.

Ndërsa, sa i përket aktiviteteve në kuadër të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit, janë mbajtur tryeza diskutimi dhe aktivitete sensibilizuese me praninë e përfaqësuesve të institucioneve lokale dhe organizatave joqeveritare.

ZBGJ ka luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e informimit, ndërgjegjësimit dhe promovimit të barazisë gjinore në nivel lokal. Përmes aktiviteteve dhe bashkëpunimeve me aktorë të ndryshëm, janë arritur rezultate të prekshme në fuqizimin e grave dhe përmirësimin e mekanizmave kundër dhunës në familje.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Vitisë: në raport ka përfshirë angazhimin dhe rezultatet e arritura nga Komuna e Vitisë në periudhën janar – dhjetor 2023, me fokus në avancimin e barazisë gjinore, të drejtave të njeriut dhe masave për mbrojtjen nga dhuna në familje. Përmes aktiviteteve të ndërmarra, është synuar rritja e ndërgjegjësimit, përmirësimi i politikave dhe fuqizimi ekonomik e social i grupeve të cënueshme. Gjatë vitit ka monitoruar zbatimin e ligjeve të aplikueshme për barazinë gjinore dhe harmonizimi i akteve normative nga institucionet komunale, përfshirja e perspektivës gjinore në KAB 2024–2026 dhe planifikimi i buxhetit komunal nga këndvështrimi gjinor, analiza gjinore në sektorët e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Bujqësisë.

ZBGJ ka organizuar dy trajnime për obligimet që dalin nga Strategjia për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Konventa e Stambollit (26 zyrtarë të trajnuar). Trajnim për Protokollin Shtetëror kundër Sulmeve Seksuale (8 zyrtarë të Komunës së Vitisë). Trajnim kundër ngacmimeve seksuale në vendin e punës, mbështetur nga ABGJ dhe IKAP (18 zyrtarë të trajnuar).

Sa i përket fushatës ndërgjegjëse në kuadër të Javës së Edukimit për Barazi Gjinore në mars janë mbajtur aktivitete nëpër shkollat, ligjërata për parandalimin e dukurive negative, përfshirë trafikimin, dhunën në familje, keqpërdorimin e rrjeteve sociale dhe përdorimin e narkotikëve (përfutur: 560 nxënës). Organizimi i Javës për Kompensimin e Viktimave të Krimit (shpërndarje posterësh informues).

Ndërsa, sa i përket fuqizimit ekonomik dhe social komuna e Vitisë ka ndarë grante për fuqizimin ekonomik të grave në partneritet me IADK, IKC dhe Caritas Zvicerran (biznese për përpunimin e ushqimit).

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë Kosovës: gjatë periudhës mars 2023 dhe përgjatë aktiviteteve të tjera të planifikuara, ka realizuar një sërë iniciativash me qëllim promovimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut. Raporti përmbledh aktivitetet kryesore, fushatat, trajnimet dhe rezultatet e arritura.

Me qëllim të promovimit të barazisë gjinore është mbajtur Java e Barazisë Gjinore, në gjitha shkollat fillore dhe të mesme të komunës është ligjëruar për rendesinë e Ditës Ndërkombëtare të Gruas dhe duke prezantuar Ligjit për Barazi gjinore Neni 21- Edukimi për Barazi Gjinore. Në kuadër të aktiviteteve për javën e barazisë gjinore janë organizuar tryezë me temë: Roli i gruas në nivel lokal, takim informuese me gratë në biznes. Vizitë Strehimore me grupin e grave, që mbështet viktimat e dhunës në familje për t'u njohur nga afër me punën e tyre.

Në bashkëpunim me Organizatën “Qendra për Promovimin e Drejtave të Grave” përmes punimeve të grave të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës vendosja e Këndit të Kurajos në hollen e komunës. Takime pune me Mekanizmin Kundër Dhunës në Familje me qëllim të hartimit të, Planit lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 -2026), të mbështetur nga OSBE, i cili plan me datë 29.12.2023 është aprovuar në mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Janë mbajtur dy takim informues me gratë për mundësitë e përfitimeve nga Programet Komunale, dy takime informuese. Takim informues për shëndeti dhe semundje të ndryshme në bashkëpunim me QKMF. Takim informues për rëndësinë e strehimit familjar me organizatën OFAP. Takime vetëdijesuese me gratë për kancerin e gjirit, takim me gratë e prekura nga kanceri i gjirit në bashkëpunim me QKMF dhe Instituti kombëtar i Shëndetësisë Publike.

Takim informues për “Rolin e gruas në nivel lokal” të mbështetur nga OSBE me qëllim të diskutimit për sfidat dhe rolin e grave në nivel lokal si dhe rekomandimet për Deputetet e Kuvendit të Kosovës, pjesëmarrëse në takim ishin deputetia Rrezarta Krasniqi, përfaqësueset nga Agjencia për Barazi Gjinore, gratë nga institucione të ndryshme dhe shoqëria civile.

Fushatë promovuese me qëllim të promovimit të Udhëzimit Administrativ për regjistrimin e pronës së palujtshme në emër të dy bashkëshortëve, materiale informuese dhe Ligjin Kunder Diskriminimit me nxënësit, takime materiale informuese.

Implementimi i projektit; Promovimi i pakos legjislativë për të drejtata e njeriut dhe barazinë gjinore, punëtori “Sfidat e implementimit të Ligjit për Barazi Gjinore.”

Vizitë pune Bashkia Tiranë, Shkëmbim eksperiencash në fushën e të Drejtave të Njeriut – Barazisë Gjinore, me drejtoreshen e Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale znj. Anisa Subashi dhe koordinatoren në Sektorin e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, znj. Anjeza Bojaxhiu, me gratë nga administrata komunale.

Fushata 16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore, në bashkëpunim me Mekanizmin Lokal kunder dhunës në familje, me qëllim të ndërgjegjësimit për pasojat e dhunës, takime informuese me qytetaret: 5 takime me nxënësit, dy takim me gratë, të rinjet e komunitetit ashkali, takime informuese me bizneset, punëtorët shëndetësor



Zyra për Barazi Gjinore në Komunën e Klinës: ka realizuar disa punëtori, tryeza dhe takime gjatë vitit 2023, duke ndjekur prioritetet kryesore të saj për promovimin e barazisë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave, dhe zbatimin e ligjeve relevante për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në familje.

Në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas ZBGJ ka oorganizuar tri aktivitete te ndryshme, duke nisur fillimisht me aktivitete sportive në volejbolli ku moren pjesë ekipe te ndryshme ku u përfaqesuan nga nënkryetarja e komunës së Klinës, Drejtoresha e Kulturës Rinisë dhe Sportit, drejtoresha te shkollave dhe mesimshënës, përfaqësuese nga Kfori Italian, Policia e Kosovës etj. Takime për muajn mars vazhduan me mbajtjen e aktiviteteve, ku uorganizua orë letrare në hapësirat e bibliotekës së qytetit “Kongresi i Manastirit”. Në këtë orë letrare morën pjesë nënkryetarja e komunës së Klinës, znj. Marqe Tanushi-Selmanaj, drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, znj. Fatjona Gashi, mësimdhënëse e nxënëse nga shkollat e komunës së Klinës, Gra përfaqësuese nga asambleja komunale, përfaqësuese nga KFOR-i Italian dhe media.

Ndërsa aktiviteti i tretë me radhë ne kuader të Ditës Ndërkombëtare të Gruas ishte ndarja e mirënjohjeve për gratë e para nismëtare të Klinës, në sallën e Kuvendit Komunal Klinë.

ZBGJ ka bërë hapjen e fushatës të ndërgjegjësimit kundër kancerit të



gjirit, me ligjëratë vetëdijesuese kundër kancerit të gjirit. Në praninë e një numri të madh të grave pjesëmarrëse, mediave, drejtori i Qendrës Kryesore së Mjekësisë Familjare “Nënë Tereza”, dhe nënkryetarja e Komunës.

Po ashtu është mbajtur marsh nëpër qendrën e qytetit të Klinës me moton “Jemi bashkë”. Në kuadër të fushatës në komunën e Klinës është vendosur Mamografia Mobile e cila ka qenë në shërbim nga dt 9 -12 tetor.

Në kuadër të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit ZBGJ në bashkëpunim me misionin Eulex dhe organizatën Assist Kosovo është hap fushata me moton Ne jemi bashkë, me marsh në qender të qytetit, u mbajtur tryezë diskutimi me qëllim të fuqizimit ekonomik të grave, si dhe u prezantua nje ekspozitë nga fëmijët t shkollës “Atë Shtjefën Gjeqovi”.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Deçanit: ka prezantuar raportin vjetor për vitin 2023, ku janë pasqyruar aktivitete që kanë pasur si prioritet zbatimin e politikave komunale dhe respektimin e kornizës ligjore për Barazi Gjinore, në veçanti Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore. Qëllimi kryesor ka qenë ofrimi i shërbimeve dhe të mirave për të arritur standardet e përcaktuara për barazi gjinore në nivel lokal.

Në shënim të muajt kundër kancerit të gjirit ZBGj se bahsku me grupin e grave asambleiste kanë organizuar marsh ndëgjegjëses, mbjellja e pemës në qendër të qytetit, Ekspozitë dhe pikturim në qendër të qytetit me motive të kësaj ngjarje nga gjimnazistët e Gjmnazit “Vëllezërit Frashëri” në Deçan, si dhe janë mbajt ligjerata për vetëdijësimin dhe parandalimin e kancerit të gjirit



Në kuadër të fushatës “16 ditë aktivizëm kundër dhunës në bazë gjinore”, kryetari i komunës, z. Bashkim Ramosaj ka themeluar Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje.

Së bashku me anëtarët e këtij Mekanizmi, të cilët njëkohësisht përfaqësojnë institucione të rëndësishme në luftimin e kësaj dukurie, kanë nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për institucionalizimin e mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje dhe mënyrën e funksionimit të tij në Komunën e Deçanit.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve përgjegjëse në Komunën e Deçanit, për trajtimin e çështjeve të dhunës në marrëdhëniet familjare, përmes institucionalizimit të Mekanizmit Koordinues. Në kuadër të fushatës është hartuar Strategjia për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj grave dhe plani i veprimit 2023-2027, një video spot me moton: “Dhuna në familje është e papranueshme dhe duhet të dënohet, të luftohet dhe parandalohet me çdo kusht”, botimi i broshurës informuese me infrastrukturën ligjore që rregullon dhe përmirëson nivelin e sigurisë dhe efikasitetit për parandalimin, trajtimin dhe ri-integrimin e rasteve të dhunës në familje. Po ashtu, takime sensibilizuese dhe informuese për dhunën në familje dhe pasojat e dhunës me nxënës të shkollave të mesme dhe fillore. Marshi në qytetin e Deçanit.

Gjatë këtij vitit Komuna i ka ftuar të gjitha gratë, bizneset e të cilave kanë potencial për eksport që të përfitojnë nga programi i mentorshipit nga Organizata Germin, për një periudhë shtatë (7) mujore nga profesionistët/et e diasporës. Organizata Germin me përkrahje të "USAID Compete Activity" ka për qëllim të krijojë një lidhje mes grave që udhëheqin dhe menaxhojnë bizneset në Kosovë dhe bizneseve dhe profesionistëve të biznesit në diasporë. Profesionistët nga diaspora do të shërbejnë fillimisht si mentorë për bizneset e udhëhequra nga gratë në Kosovë, me qëllim të rritjes së kapaciteteve dhe aftësive të tyre biznesore dhe më pastaj krijimin e mundësive për eksport. Germin do të përzgjedhë 10 profesionist/e nga Diaspora të cilët për një periudhë shtatë (7) mujore do të angazhohen si mentorë/e për 45 gra ndërmarrëse në Kosovë, me synimin që këto të fundit të ngritin njohuritë nga përvoja e homologëve të tyre në diasporë si dhe të identifikojnë mangësitë eventuale që i kanë në bizneset e tyre.

Komuna e Decanit këtë vit ka ndarë mjete financiare për Qendrën për Mirëqenien e Gruas-OMG- sipas Memorandum të Mirëkuptimi të nënshkruar në mes të komunës së Deçanit dhe Qendrës për Mirëqenien e Gruas Strehimore për Viktimat e Dhunës. Qëllimi i kësaj mbështetje është të përkrahet QMG me mjete financiare për të ofruar shërbime të strehimit, rehabilitimit dhe re integrimi për gratë e fëmijë viktimave të dhunës në familje të Komunës së Deçanit.

Zyra për Barazi Gjinore në Komunën e Prizrenit: ka realizuar një sërë aktivitete të rëndësishme, duke përfshirë takime, trajnime dhe tryeza të ndryshme, si pjesë e angazhimeve për promovimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut. Me anëtarët e Mekanizmit komunal kundër dhunës në familje është mbajtur trajnim njëditor të organizuar nga QSGF-Strehimorja e grave. Trajnimi ka qenë i dedikuar për ngritje të kapaciteteve të anëtarëve në drejtim të trajtimit të rasteve të dhunës, të përkrahur financiarisht nga Ambasada Amerikane në Kosovë. ZBGJ ka kontribuar në realizimin e analizës gjinore në Drejtorin e Kulturës. Për realizimin e këtij aktiviteti është përcaktuar një konsulent nga SIDA.

Është mbajtur një trajnim për Mekanizmin komunal kundër dhunës në familje për Protokolin Shtetëror dhe trajtimin e rasteve nga dhuna seksuale. Ky aktivitet u zhvillua nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) në bashkëpunim me Qëndren për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Prizren QSGF. Me qëllim të njoftimit dhe gjithpërfshirjes së grave në zbutjen e krizës energjetike kemi organizuar mbajtjen e një ligjerate nga anëtarët e Shoqatës së grave nga sektori i energjisë-AWEKS në temën “Gratë për gratë-Efienca dhe kursimi i energjisë elektrike” me diku 20 veta me profile të ndryshme, gra amvise, gra që punojnë, gra që kanë biznes personal. Me OJQ Sakuntala është realizuar një tryezë diskutimi me zyrtar relevant institucional në temën e punësimit të grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase. Në bashkëpunim me OJQ Qeliza, është mbajtur trajnimi i parë me vajza të reja me temën e drejtave të grave në punë dhe sfidat e punësimeve si dhe trajnimi me mësimdhënës në temën të drejtave të grave në punë. Po ashtu, është realizuar tryezë diskutimi me OJQ “Qeliza” gra që posedojnë biznese mbi drejtat e grave nga marrëdhënia e punës dhe sfidat me të cilat ballafaqohen ato.

Mekanizmi Koordinues Komunal kundër Dhunës në familje ka mbajtur trajnim njëditorë në temën e Trajtimit të traumave tek fëmijet si pasojë e përjetimit të dhunës si dhe ka mbajtur trajnim për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga dhuna në Familje. Janë shqyrtuar Korniza ligjore, kuptimi i dhunës, trauma dhe mbështetja psiko-sociale dhe Sfidat e Mekanizmit. Është mbajtur takimi i Komitetit për barazi gjinore ku janë sugjeruar aktivitete për realizim të kontrollimeve falas të grave gjatë muajit kundër kancerit të gjirit në QKMF. Gjithashtu është iniciuar edhe kontrolli i veçanti për një grup prej 30 grave të komunitetit Rom, Ashkali dhe egjiptase në QKMF. Në kuadër të fushatës janë kontrolluar rreth 400 gra në muajin Tetor po edhe në vazhdim të muajve të tjerë, për shkak të fluksit të madhe të grave të interesuara e vetëm një mjeke e punësuar në këtë repart.



Me përfaqësuese të Bashkësisë Islame të grave janë mbajtur takime konsultative për situatën e barazisë gjinore dhe sfidat me të cilat ballafaqohen gratë.

Sipas të dhënave të pranuara nga disa prej institucionet që i kanë dërguar raportet statistikore gjendja dhe trajtimi i rasteve të dhunës në familje gjatë vitit 2023. Në Qendrën për punë sociale janë trajtuar 178 raste të dhunës në familje prej tyre 107 raste të moshës madhore, 130 raste të gjinisë femrore dhe 48 të gjinisë mashkullore. Rastet janë referuar nga policia, gjykata dhe vet referim. Institucioni i Policisë ka trajtuar 248 raste të domenit të dhunës në familje. Qendra për strehimin e grave ka strehuar 45 raste.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Drenasit: ka raportuar për përpjekjet e rëndësishme për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me një fokus të veçantë në barazinë gjinore duke implementuar ligje dhe konventa ndërkombëtare.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ZBGJ, në bashkëpunim me Grupin e Grave Asambliste, realizoi një sërë vizitash dhe aktivitete për të promovuar rolin dhe të drejtat e grave në shoqëri.

- Vizita në Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave (QPDG) ku u diskutuan sfidat me të cilat përballen gratë gjatë rrugëtimit të tyre personal dhe profesional si dhe u premtua përkrahje e vazhdueshme nga Komuna për realizimin e projekteve të qendrës.
- Vizita në Qendrën Edukativo-Arsimore dhe Përkujdesëse "Ardhmëria" (QEAP) ku u diskutua për kushtet e qëndrimit të fëmijëve dhe aktivitetet e zhvilluara për ta.
- Vizita në Qendrën e Mjekësisë Familjare (QKMF) ku u njoftuan me shërbimet që ofrohen për qytetarët, veçanërisht për grate si dhe u diskutuan sfidat kryesore, si mungesa e medikamenteve dhe shërbimet e tjera të nevojshme.

Gjatë të gjitha këtyre vizitave dhe takimeve, u theksua rëndësia e rolit të gruas në shoqëri, sfidat që ato përballen dhe domosdoshmëria e mbështetjes së vazhdueshme nga institucionet komunale. U theksua gjithashtu se përkrahja institucionale dhe përmirësimi i kushteve për grate mbetet prioritet i rëndësishëm.



Komuna e Drenasit organizoi hapjen e fushatës ndërgjegjëse kundër kancerit të gjirit, në kuadër të muajit Tetor, i njohur ndryshe si "Muaji Rozë", ku aktivitetet u koordinuan nga ZBGJ, Drejtoria e Shëndetësisë dhe përfaqësues tjerë të institucioneve dhe OJQ.

Vizita u realizuan në QKMF, në QPS, dhe vizitë në Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave ku qëllimi i vizitave ishte të nxisë gratë të bëjnë kontrole të hershme dhe të sensibilizohen për rëndësinë e diagnostikimit të hershëm në luftën kundër kancerit të gjirit. Gjatë gjithë vizitave, u shpërndanë fletëpalosje dhe paster, ndërsa u ngjiten kordela rozë në shenjë mbështetjeje për fushatën. Kjo fushatë vazhdoi të shërbejë si një shtysë për të gjithë gratë që të kryejnë kontrole të rregullta dhe të kenë një shëndet të mirë.

Në kuadër të Fushatës së 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës në Bazë Gjinore, që zhvillohet nga data 25 deri më 10 Dhjetor 2023, ZBGJ në bashkëpunim me DKA, QPS dhe Policinë e Kosovës, mbajten tryeza diskutimi, u organizuan ligjërata të rëndësishme në SHFMU "Bajram Curri", në fshatin Nekoc, SHFMU "Shotë Galica", Abri e epërme. Pjesëmarrësit ishin nxënësit e klasave VIII dhe IX, gra të komunitetit lokal dhe përfaqësues nga institucionet bashkëpunuese. Tema: "Parandalimi i Dhunës në Bazë Gjinore dhe Ngritja e Vetëdijes së Qytetarëve". Pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime aktive dhe ndanë perspektivat e tyre mbi mënyrat për të luftuar dhunën dhe për të krijuar një komunitet të sigurt dhe të barabartë. Ky aktivitet shërbeu si një hap i rëndësishëm në promovimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në komunën e Drenasit. Rastet e dhunës në familje gjatë vitit 2023, janë 61 ,prej tyre 54, raste kanë qenë dhunë fizike, ndërsa 7 raste kanë qenë dhunë psikike emocionale ekonomike.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Istogut: ka realizuar një sërë aktiviteteve dhe tryezash gjatë vitit 2023, në përputhje me Planin e Punës vjetor, duke promovuar barazinë gjinore dhe përfshirjen shoqërore në fusha të ndryshme. Në shënim të 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas në bashkëpunim me OSBE, u organizua një trajnim me temë “Sfidat, Vështirësitë dhe të Arriturat e Grave”, ku morën pjesë përfaqësues të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare. Aktiviteti synoi të rrisë ndërgjegjësimin dhe të promovojë diskutimin mbi sfidat dhe sukseset e grave në shoqëri.

Në partneritet me Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi dhe përkrahjen e OSBE-së, ZBGJ organizoi dy takime ku u diskutua rreth vetëdijesimit të grave lidhur me të drejtën në trashëgimi dhe pronë. Pjesëmarrësit përfshinin përfaqësues të administratës komunale dhe të drejtorisë për kadastër. Gjatë takimeve u shpërndanë fletushka me informacione të dobishme për këtë temë.

Në shënim të muajt kundër kancerit të gjirit në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe OSBE, u organizuan aktivitete ndërgjegjëse për: Parandalimin dhe trajtimin e hershëm të kancerit të gjirit si dhe nxitjen e grave për kontrolle të rregullta mjekësore.

Fushata Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas u organizua në bashkëpunim me NDI ku u mbajtën tri takime informuese me nxënësit dhe katër tryeza diskutimi me aktorë institucionalë si: Policia e Kosovës, Qendra për Punë Sociale, Përfaqësues nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe këshillat juridike falas, Përfaqësues nga OJQ-të dhe administrata komunale. Në takime u diskutuan format e dhunës, parandalimi dhe mekanizmat e raportimit. Gjatë këtyre aktiviteteve u shpërndanë broshura me moton: “SOT DHE ÇDO DITË TJETËR”.

Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për institucionalizimin e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje, ZBGJ u caktua si anëtare dhe koordinatore e këtij grupi, duke marrë rol aktiv në mbikëqyrjen dhe koordinimin e aktiviteteve për parandalimin e dhunës.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Dragashit: ka realizuar një sërë aktivitete dhe projekte të parapara në Planin e Punës vjetor, si dhe disa të paplanifikuara, me mbështetjen e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, si dhe të vetë Komunës.

Në shënim të 8 Marsit – Dita Ndërkombëtare e Gruas organizoi një takim me pjesëmarrjen e Kryetarit të Komunës, grave të institucioneve komunale, asamblistëve dhe familjarëve të dëshmorëve në sallën e Asamblesë Komunale. Diskutimet u fokusuan te roli i grave në shoqëri dhe përpjekjet për përparimin e barazisë gjinore. Pjesëmarrësit vizituan Qendrën e Grave në Drenas, duke përforcuar bashkëpunimin ndërkomunal.

Me qëllim të fuqizimit ekonomik dhe integritetit të grave u mbajt një punëtori njëditor me gratë gorano-boshnjake, në bashkëpunim me OJQ-në "Sensa" dhe me mbështetjen e OSBE-së, me temë fuqizimi ekonomik dhe integrimi i grave në shoqëri. Gjatë qershorit, në bashkëpunim me asamblistë, u mbajtën dy takime me gra në fshatrat Bresanë dhe Kosovë për të dëgjuar nevojat e tyre dhe për të diskutuar përfshirjen e kërkesave të tyre në planin buxhetor të vitit të ardhshëm. Në bashkëpunim me OSBE, u organizua një punëtori dyditor me temë “Roli i Grave Anëtare të Kuvendit Komunal dhe Grave të Palëve të Interesuara”, ku u përfshinë gra nga komunat Dragash, Obiliq dhe Graçanicë për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira.

Në bashkëpunim me OJQ-në "Sensa" dhe OSBE-në, u mbajt një takim sensibilizues me vajza të reja shqiptare dhe gorano-boshnjake, ku u shpërndanë broshura ndërgjegjëse për të drejtat dhe mundësitë e tyre. Në bashkëpunim me Qendrën e Grave në Drenas dhe



Komunën, u vendos “Këndi i Kurajos” në objektin e Komunës. Hapja u realizua nga Kryetari i Komunës në Ditën e Çlirimit të Dragashit. Në këtë hapësirë janë ekspozuar punime artizanale të grave – viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

ZBGJ organizoi një tryezë dhe aktivitete ndërgjegjëse për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj grave kundër kancerit të gjirit, në bashkëpunim me gratë asambleiste, aktiviteti u realizua në kuadër të muajt tetor, muajt kundër kancerit të gjirit.

Në bashkëpunim me UN Women, u realizua një analizë gjinore e Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit. Si rezultat, u mbajt një trajnim njëditor me mësuesin e edukatës fizike për integrimin gjinor në politikat sportive në nivel lokal.

Mekanizmi Komunal ka mbajtur pesë takime periodike, ku janë mbledhur të dhëna dhe janë diskutuar shqetësimet dhe nevojat ndërinstitutionale për adresimin e dhunës në familje.

Në kuadër të Fushatës “16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës në Familje ZBGJ organizoi tre sesione informuese me nxënës në shkollat e Brodit, shkollën e mesme, dhe klasën e IX në shkollën e Bresanës. Një takim u mbajt me mësimdhënës dhe edukatore të shkollës “28 Nëntori” në Bresanë me temën “Të Kuptuarit e Barazisë Gjinore dhe Dhuna në Familje” ndersa një takim u realizua me Ministren e Drejtësisë dhe gratë shqiptare dhe gorano-boshnjake, ku u diskutua për punën e institucioneve qeveritare në fushën e dhunës në familje.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në komunën e Hanit Elezit: ka realizuar aktivitete gjatë vitit 2023 për promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave dhe rritjen e vetëdijes për barazinë gjinore. Aktivitetet e realizuara kanë përfshirë: Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ZBGJ në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit ka mbajtur një ligjëratë në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët "Veli Ballazhi" për rëndësinë e barazisë gjinore. Aktiviteti ka shërbyer për të promovuar barazinë gjinore dhe për të inkurajuar gratë dhe vajzat të angazhohen në shoqëri.

Komuna e Hanit të Elezit ka mbështetur organizimin e edicionit të tetë të panairit të produkteve vendore, duke promovuar ushqimin tradicional dhe duke mbështetur gratë e përfshira në prodhimin e këtyre produkteve. Ky aktivitet ka ndihmuar në forcimin e pozitës ekonomike të grave dhe ka promovuar kulturën dhe traditat lokale.

Gjatë muajit tetor, me rastin e "Tetorit Rozë", është organizuar një marsh sensibilizues për të rritur ndërgjegjësimin mbi kancerin e gjirit. Aktiviteti është udhëhequr nga Kryetari i Komunës, Mehmet Ballazhi, dhe ka përfshirë gratë e prekura nga kanceri i gjirit. Gjatë këtij muaji, janë mbajtur takime informuese për gratë në zonat rurale si Seçishtë, Paldenicë dhe Gorancë, ku është diskutuar për parandalimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit. Për 20 gra është mundësuar bërja e mamografisë në Spitalin e Ferizajit. Si pjesë e fushatës "Tetori Rozë", janë mbjellë lule ngjyrë pembe në të gjitha parqet e komunës për të shprehur solidaritet me gratë që luftojnë kundër kancerit të gjirit.



Gjatë fushatës ndërkombëtare të 16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës në Bazë Gjinore, janë organizuar ligjërata dhe takime informuese me nxënës në shkollat e komunës, në bashkëpunim me Drejtorinë e QPS-së. Kjo fushatë ka pasur për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për dhunën në bazë gjinore dhe për rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të grave dhe vajzave.

Po ashtu në kuvendin Komunal është mbajtur seancë për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës në bazë gjinore. Pjesëmarrësit kanë diskutuar për masat dhe mekanizmat për mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës.

ZBGJ ka organizuar një takim informues në bashkëpunim me Institutin e Prishtinës për Studime Politike (PIPS), një program gjashtëmuor për informimin e të drejtave të njeriut. Ky program ka synuar të ofrojë informacione të rëndësishme dhe mbështetje për komunitetet joshumicë në Kosovë, dhe komuna do të vazhdojë bashkëpunimin për sesione informuese për komunitetin lokal.

Zyrtari për Barazi Gjinore në Komunën e Lipjanit: ka realizuar një sërë aktivitete të rëndësishme gjatë vitit 2023, të fokusuara në fuqizimin ekonomik të grave, përmirësimin e barazisë gjinore dhe adresimin e çështjeve të dhunës në baza gjinore. Në bashkëpunim me USAID është mbajtur diskutimi lidhur me vlerësimin e kapaciteteve të komunës për identifikimin dhe menaxhimin e pronës së paluajtshme komunale, në takim ishin present zyrtar komunal. Bashkëpunimi me USAID vazhdoj edhe me mbajtjen e një punëtorie për qasjen e barabartë dhe të drejtat e trashëgimisë ku moren pjesë gra nga zonat rurale, duke promovuar përfshirjen e tyre në menaxhimin e pronës dhe të drejtave të trashëgimisë.

Gjatë vitit u mbajtën edhe një sërë takimesh, me Qendren për Promovimin e Drejtave të Grave u mbajt takim me temë “Mbështetja e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”.

ZBGJ kishte bashkëpunim me organizaten YAHR ku u mbajtën takime me temën; “Përfshirja e çështjes gjinore në aktet normative në nivel lokal” me pjesëmarrjen e institucioneve lokale, subjekteve politike dhe shoqërisë civile.

Në kuadër të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit janë organuar aktivitete të ndryshme përfshir shpërndarjen e materialeve vetëdijesuese si fjongo dhe fletëpalosje me ngjyrë portokalli, janë mbajtur sesione informuese me nxënësit e shkollave fillore “Vëllezërit Frashëri” dhe “Ismail Luma” në Lipjan, si dhe në Qendrën Korrektuese Edukative për të Mitur (QKL-Lipjan) dhe Bashkësinë Islame në Lipjan.



Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Malishevës: realizoi një sërë aktivitete të përmbledhura sipas planit vjetor të punës, të cilat kanë ndikuar në ngritjen e kapaciteteve të grave në fusha të ndryshme. Aktivitetet u përqendruan në debate, fushata, spote promovuese (me theks te e drejta për trashëgimi dhe pronë), rekomandime, punëtori dhe bashkëpunime ndër-komunale.

Debatet dhe aktivitetet përfshinë diskutime mbi tema të ndryshme të rëndësishme për fuqizimin e grave dhe promovimin e barazisë gjinore, si Barazia gjinore në familje, shkollë dhe shoqëri: Theksimi i rëndësisë së trajtimit të barabartë dhe rolit të grave në këto mjedise. E drejta nga marrëdhënia e punës dhe integrimi gjinor: Diskutime mbi të drejtat në vendin e punës dhe mundësitë për rritje profesionale. Komunikimi menaxherial dhe ngacmimet seksuale: Edukimi mbi komunikimin efektiv në nivel menaxherial dhe parandalimin e ngacmimeve seksuale. Shëndeti dhe mirëqenia: Përmirësimi i qasjes në shërbime dhe informacione shëndetësore për gratë. Pjesëmarrja në proceset vendimmarrëse: Sensibilizimi mbi rolin e grave në vendimarrje dhe sfidat aktuale në këtë drejtim.

Edukimi për
feminizmin: Rritja e
ndërgjegjësimit mbi
parimet dhe
rëndësinë e
feminizmit.
Mundësitë për
përfitim nga
programet bujqësore:
Informimi i grave mbi
mbështetjet dhe
grantet në sektorin e
bujqësisë. Dhuna në
familje dhe mbrojtja
nga trafikimi: Sesione
këshilluese dhe



edukative për parandalimin e dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Mbrojtja nga diskriminimi: Adresimi i formave të ndryshme të diskriminimit dhe ofrimi i rekomandimeve për trajtimin e tyre.

Takimi i parë me temën “T’i njohim të drejtat tona” përfshiu diskutime mbi Ligjin për Barazi Gjinore dhe të drejtën e pronës. Gratë u informuan mbi mundësitë e përfitimit nga programet bujqësore, ndërsa strategjia zhvillimore e bashkëpunimit ndër-institucional u prezantua si mjet për përmirësimin e mirëqenies socio-ekonomike të grave dhe rritjen e bizneseve të tyre. Java e Edukimit për Barazi Gjinore u shënua me aktivitete në shkollë, ku nxënësit prezantuan ese dhe punime artistike mbi barazinë gjinore. Fituesit e aktiviteteve u nderuan me mirënjohje gjatë një ceremonie solemne.

Në bashkëpunim me organizata të ndryshme dhe institucione, janë vizituar organizata si shoqata "Fatjona", e cila punëson gra në kultivimin dhe konservimin e perimeve. Po ashtu, u mbajtën trajnime për fuqizimin e grave në biznes dhe edukimin e tyre mbi feminizmin.

Fuqizimi i grave në biznes ishte një tjetër prioritet, ku nëntë gra hapën biznese të reja falë mbështetjes së organizatës "PredaPlus". Ndërkohë, u diskutua edhe për renovimin e një qendre komunitare, e cila do t'i shërbejë grave për aktivitete dhe promovimin e bizneseve të tyre.

Aktivitetet ndërgjegjësuere dhe bashkëpunimet ndër-institucionale përfshinë punëtorin dhe tryeza diskutimi mbi temat si dhuna në familje, sfidat në proceset vendimmarrëse, dhe të drejtat në punë. U theksua rëndësia e bashkëpunimit ndër-institucional për parandalimin e dhunës dhe mbështetjen e viktimave.

Një marsh simbolik me moton "Së bashku do ia dalim" u organizua për sensibilizimin mbi zbulimin e hershëm të sëmundjeve dhe rëndësinë e kontrolleve të rregullta shëndetësore.

Në kuadër të projektit "Gratë, Paqja dhe Siguria", u mbajt një takim joformal mes grave të komunitetit dhe institucioneve komunale në Malishevë, ku u diskutua për sfidat dhe mundësitë për të përmirësuar qasjen ndaj drejtësisë dhe mbështetjes institucionale.

Në bashkëpunim me fondin kosovar për garanci kreditore realizuan punëtorinë dy ditore me gratë në biznes, për avancimin e njohurive financiare, me ç'rast të pranishmet patën mundësin të fitojnë njohuri lidhur me menaxhimin e bizneseve të tyre.

Hapja zyrtare e aktiviteteve u shënuar me një takim koordinues me zyrtarë nga Qendra për Punë Sociale. Në këtë takim u diskutua për sfidat e rasteve të dhunës në familje, ndihmën dhe mbështetjen institucionale për viktimat, përfshirë strehimin dhe përkrahjen socio-ekonomike.

Në një tjetër takim me kryetarin e komunës dhe zyrtarë të Qendrës për Punë Sociale, u theksua nevoja për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, veçanërisht në trajtimin e rasteve të dhunës, mbështetjen për fëmijët e braktisur dhe familjet strehuese.

Ligjëratat me nxënës të shkollave të mesme u fokusuan në definimin e dhunës në baza gjinore, faktorët që e shkaktojnë atë, dhe rolin e institucioneve përkatëse. Këto aktivitete kishin për qëllim rritjen e ndërgjegjësimin dhe aktivizimit të të rinjve për të denoncuar çdo formë dhune. Gjithashtu, fletëpalosje të përgatitura nga Zyra për Barazi Gjinore, me pjesë nga Konventa e Stambollit, u shpërndanë për të informuar nxënësit dhe stafin shkollor.

Punëtoritë me nxënësit trajtuan tema si barazia gjinore në shkollë dhe familje, diskriminimi, dhe dhuna në familje. Nxënësit ndanë përvojat e tyre dhe diskutuan mënyrat për t'u përballur me këto probleme. Ata krijuan punime kreative që shpalosën zanafillën e dhunës dhe ndikimin negativ të saj në shoqëri.

Mbyllja e aktiviteteve për vitin 2023 u shënuar me një takim përmbledhës ku u diskutua mbi arritjet dhe planet për të ardhmen. Aktivitetet për vitin 2024 do të përfshijnë kampanja sensibilizuese kundër dhunës dhe diskriminimit, promovimin e grave në proceset vendimmarrëse, dhe të drejtën e pronës për të dy bashkëshortët.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Skenderajt: ka realizuar një sërë aktivitete të rëndësishme gjatë vitit 2023, duke kontribuar në fuqizimin e gruas dhe sensibilizimin për çështje të barazisë gjinore. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ZBGJ organizoi një takim me gratë e institucionit komunal, ku u diskutua rreth fuqizimit të grave në politikë dhe vendimmarrje. Gjatë aktivitetit, Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik dhe Inovacionit ofroi informacion mbi mundësitë e mbështetjes përmes granteve dhe subvencioneve, ndërsa Drejtoresha e Gjeodezisë dhe Kadastrës theksoi rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve apo vetëm të gruas. Aktiviteti përfshiu gjithashtu nderimin e grave pensioniste me mirënjohje për kontributin e tyre. Në kuadër të aktiviteteve për 8 Marsin, u organizua një marsh simbolik nga objekti i Komunës deri në sheshin Adem Jashari. Më pas, një debat në Qendrën Rinore me të rinj dhe të reja adresoi rëndësinë e fuqizimit të tyre në ekonomi, politikë dhe shoqëri.

Në bashkëpunim me OSBE-në, ZBGJ realizoi trajnime për tema si dhuna në familje dhe të drejtat pronësore e trashëgimore. Në këto trajnime morën pjesë përfaqësues të Qendrës për Ndihmë Juridike Falas dhe 45 gra nga komuniteti lokal.

ZBGJ organizoi një takim me nëna vetushqyese, ku ishin të pranishme edhe përfaqësues të Ndihmës Juridike Falas dhe drejtoresha të fushave të ndryshme, duke ofruar mbështetje dhe këshilla praktike për përmirësimin e kushteve të tyre socio-ekonomike.



Gjatë vitit 2023, Komuna e Skenderajt ka mbështetur 7 organizata joqeveritare me një buxhet prej 10,000 eurosh. Në bashkëpunim me organizata të ndryshme dhe Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, janë mbajtur takime informuese me gratë e fshatit Kryshec dhe të tjera, duke diskutuar mbi aplikimet për subvencione dhe mundësitë e trajnimeve në fusha të ndryshme.

Në kuadër të fushatës së kancerit të gjirit u organizuan takime me zyrtarë komunalë dhe nxënës shkollash, duke shpërndarë postera vetëdijësues. Aktiviteti përfshiu gjithashtu një ekspozitë pikturash të nxënësve, shitja e të cilave mbështeti personat e prekur nga kjo sëmundje.

Ndërsa në shënim të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit, fushatës ndërkombëtare për Eliminimin e dhunës ndaj Gruas u organizuan takime dhe ligjërata në shkolla fillore me mbështetjen e Policisë së Kosovës, duke trajtuar tema si dhuna në familje dhe trafikimi i qenieve njerëzore. Aktivitetet përfshinë shpërndarjen e materialeve vetëdijësuese dhe organizimin e një marshimi me pjesëmarrjen e rreth 200 personave.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Gjilanit: ka raportuar për periudhën janar-dhjetor 2023 ku përmbledh angazhimet dhe arritjet në promovimin dhe integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha sektorët komunalë.

Gjatë muajit janar, Zyra për Barazi Gjinore në Gjilan, në bashkëpunim me Strehimoren “Liria”, organizoi një trajnim për anëtarët e Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje. Trajnimi u përqendrua në "Protokollin e Shtetit për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale", i cili u lansua më 5 dhjetor 2022 nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Trajnimi synonte të forconte kapacitetet e anëtarëve të mekanizmit komunal për të adresuar në mënyrë më efektive këto raste dhe për të siguruar zbatim të drejtë dhe të ndjeshëm të protokollit, me fokus të veçantë në mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e rasteve të dhunës seksuale.

Për nder të 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në Komunën e Gjilanit u inaugurua monumenti “Heroina e Qytetit”, një simbol i respektit për kontributin e jashtëzakonshëm të nënave, grave dhe vajzave në të gjitha sferat e jetës ndër vite. Ky akt nderimi vlerëson rolin e veçantë të grave në shoqëri dhe historinë e tyre të fuqizimit.



Në kuadër të aktiviteteve të “Javës së Gruas”, u organizua edhe një takim i veçantë me gratë e moshës së tretë nga OJQ “Gruaja Hyjnore”. Aktiviteti, i realizuar nga ZBGJ, në bashkëpunim me OSBE-në, Aktivin e Grave Pensioniste dhe Qendrën për Punë Sociale, u mbështet nga Zyra e Kryetarit të Komunës. Qëllimi i këtij takimi ishte adresimi i kërkesave dhe nevojave të grave të kësaj moshe për një jetë më të dinjitetshme dhe të siguri.

Në Gjilan u mbajt aktiviteti "Salloni i së Martës," i cili u fokusua në sfidat dhe mundësitë për zhvillimin e grave në ndërmarrësi. Aktiviteti mbledhi ekspertë, zyrtarë dhe gra ndërmarrëse për të diskutuar mbi pengesat që gratë përballojnë në tregun e punës dhe ndërmarrësi. Diskutimi u përqendrua gjithashtu në identifikimin e mundësive për fuqizimin e grave në ndërmarrësi, përmes programeve mbështetëse, krijimit të rrjeteve të fuqishme bashkëpunimi dhe adresimit të politikave që promovojnë barazinë gjinore. Ky event nënvizoi nevojën për

veprime të përbashkëta për të thyer barrierat ekzistuese dhe për të krijuar kushte të barabarta për gratë ndërmarrëse në komunitet.

Komuna e Gjilanit shënoi Tetorin Rozë, muajin e ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, me një sërë aktivitete të dedikuara për të rritur vetëdijen mbi këtë sëmundje dhe rëndësinë e parandalimit të saj.

Në kuadër të këtij muaji, u organizuan ligjërata vetëdijësuese, ku ekspertë shëndetësorë ndanë informacione mbi rëndësinë e kontrollave sistematike si masë parandaluese për kancerin e gjirit. Po ashtu, në galerinë e arteve të qytetit u hap një ekspozitë kolektive me moton “Thirrëm edhe mua”, e cila simbolizonte solidaritetin dhe mbështetjen për gratë që përballen me këtë sfidë shëndetësore.

Këto aktivitete jo vetëm që sensibilizuan komunitetin për rëndësinë e zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit, por edhe krijuan një hapësirë për dialog dhe mbështetje për gratë dhe familjet e prekura nga kjo sëmundje.

Më 25 nëntor, në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, në Gjilan u hap Fushata me moton “Të bashkuar kundër dhunës, MJAF!” e cila shënoi fillimin e një sërë aktivitete ndërgjegjëse.

Në kuadër të fushatës, objekti i Komunës së Gjilanit u ndriçua me ngjyrë portokalli, simbol i shpresës dhe solidaritetit kundër dhunës. U shpalosën banera me mesazhe kundër dhunës, ndërsa qytetarëve iu shpërndanë fletëpalosje, maica me mbishkrime sensibilizuese dhe shalla portokalli.

Në hapjen e fushatës, nënkryetarja e komunës dhe zyrtarja për barazi gjinore mbajtën fjalime, duke theksuar rëndësinë e bashkimit institucional dhe qytetar për t’i dhënë fund dhunës në të gjitha format e saj. Ky aktivitet ishte pjesë e nismave të vazhdueshme për promovimin e barazisë gjinore dhe për fuqizimin e mekanizmave mbrojtës ndaj grave dhe vajzave në komunitet.

Nën mbështetjen e USAID-it, në kuadër të projektit Qeverisja e Pronës, në Gjilan u realizua një takim me gra nga fusha të ndryshme, me temën: “Rëndësia e pronës në uljen e rrezikut nga dhuna në familje”. Në panel ishin nënkryetarja e komunës dhe zyrtarja për barazi gjinore, të cilat diskutuan mbi rolin vendimtar të pronës në fuqizimin ekonomik dhe social të grave.

Pjesëmarrëset, gra dhe vajza nga komuniteti, e vlerësuan trajtimin e kësaj teme si shumë të rëndësishëm, duke theksuar sfidat dhe problemet me të cilat përballen në shoqëri të ndikuara nga mendësia patriarkale. U diskutua se, megjithëse korniza ligjore garanton barazi në çështjet e pronësisë, zbatimi i saj mbetet një sfidë.

Ky takim shërbeu si platformë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe identifikimin e hapave që duhet ndërmarrë për të siguruar që gratë të kenë qasje të barabartë në pronë, si një mënyrë për të parandaluar dhunën dhe për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë.

Gjatë vitit 2023, ZBGJ në cilësinë e Koordinatorës së Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje, organizoi gjashtë takime të rëndësishme për të diskutuar dhe analizuar mënyrat më efektive të trajtimit të rasteve të dhunës në familje. Gjatë këtyre takimeve, u identifikuan sfidat kryesore me të cilat përballen institucionet përgjegjëse dhe u propozuan masa konkrete për kapërcimin e tyre.

Sipas të dhënave zyrtare nga Policia e Kosovës, në Komunën e Gjilanit gjatë vitit 2023 janë raportuar gjithsej 152 raste të dhunës në familje. Këto shifra theksojnë domosdoshmërinë e angazhimit të vazhdueshëm për të trajtuar këtë fenomen shqetësues dhe për të ofruar mbështetje për viktimat.

Takimet e ZBGJ-së u përqendruan në forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve relevante dhe në identifikimin e strategjive të reja për parandalimin e dhunës, trajtimin e rasteve dhe ndihmën për viktimat. Këto përpjekje janë pjesë e një vizioni më të gjerë për të ndërtuar një shoqëri më të sigurt dhe më të drejtë për të gjithë qytetarët.

Në kuadër të përpjekjeve për të rritur ndërgjegjësimin dhe parandalimin e dhunës në Komunën e Gjilanit, ZBGJ në bashkëpunim me CCNO - Qendra për Bashkëpunim dhe Rrjetëzim të Organizatave dhe mbështetje nga EULEX-i, organizoi një aktivitet të rëndësishëm me qytetarët. Aktiviteti u fokusua në sensibilizimin për dhunën në të gjitha format dhe në promovimin e rëndësisë së parandalimit të saj.

Gjatë këtij aktiviteti, u shfaq dokumentari "Backlash: Misogyny in the Digital Age" (Reagim: Mizogjinia në epokën digjitale), që trajtonte dhunën online ndaj vajzave dhe grave. Ky dokumentar hulumton ndikimin e mizogjinisë dhe dhunës digjitale, një fenomen që po rritet dhe po prek gjithnjë e më shumë gratë dhe vajzat, duke nxitur nevojën për ndërhyrje dhe mbrojtje të të drejtat e tyre.

Paneli diskutues për këtë çështje përfshinte nënkryetaren e Komunës së Gjilanit, ZBGJ dhe drejtoreshën e CCNO, të cilat theksuan rëndësinë e veprimit të koordinuar dhe të mbështetjes së grave dhe vajzave në trajtimin dhe parandalimin e dhunës, përfshirë atë digjitale. Kjo ngjarje ishte një hap tjetër drejt krijimit të një shoqërie më të sigurt për gratë dhe vajzat në Komunën e Gjilanit.

Gjithashtu gjatë fushatës u organizuan ligjërata nga anëtarët e Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje, në shkollat e mesme dhe fillore të Komunës së Gjilanit për rëndësinë dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Obiliqit: ka realizuar planin e punës me aktivitete dhe angazhime në takime, trajnime, dhe fushata vetëdijësuese, duke kontribuar në promovimin e barazisë gjinore dhe mbështetjen e grupeve të ndryshme shoqërore. Gjatë vitit, ZBGJ ka marrë pjesë aktive në seanca të Kuvendit Komunal, si dhe në monitorimin e komiteteve për financa dhe për komunitete, duke ndjekur nga afër zhvillimet dhe vendimet në interes të barazisë gjinore.

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas në bashkëpunim me OJQ “Shqiponjat e Dardanës”, u zhvillua një trajnim në kuadër të projektit "By Girls For Girls" me vajzat e shkollës së mesme profesionale “Ismail Dumoshi”. Ky projekt synoi edukimin dhe frymëzimin e vajzave për përdorimin e aftësive STEAM për të promovuar barazinë gjinore. Po ashtu, në bashkëpunim me kryetarin e komunës, u mbajt një takim me përfaqësueset e ndërmarrjes “99 Lule”. Qëllimi ishte mbështetja e grave në agrobiznes, duke ofruar fidane për bimë mjekësore dhe aromatike dhe sigurimin e tregut për produktet e tyre.

Në organizatën e pleqve “Qëndrimi Ditor” u themelua një aktivë për gratë, duke zgjedhur edhe kryetaren e saj. Kjo organizatë, e subvencionuar nga komuna me 3000 euro, përfshin 130 të moshuar, nga të cilët 65 gra, dhe ofron aktivitete të ndryshme për këtë kategori.

Në kuadër të 16 Ditët e Aktivizmit fushatës ndërkombëtare kundër dhunës ndaj gruas dhe dhunës me Bazë Gjinore me mbështetjen e USAID-it, u organizua diskutimi “Sot dhe çdo ditë tjetër” me qytetarët e komuniteteve pakicë, ku u trajtua tema e të drejtave pronësore si faktor për zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore. Një ekspozitë arti me nxënës të shkollave të mesme nën të njëjtin slogan paraqiti format e dhunës përmes artit, duke ndërgjegjësuar publikun. Në bashkëpunim me Grupin e Grave dhe Drejtorinë e Shëndetësisë, u organizuan ligjërata vetëdijësuese për kancerin e gjirit me gratë e zonave rurale, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë informimit dhe parandalimit.

Zyrtari për Barazi Gjinore në Komunën e Rahovecit: ka realizuar një sërë aktivitete gjatë vitit 2023, duke u bazuar në planifikimet, objektivat dhe detyrat e tij për promovimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të grave.

Me rastin e 8 Marsit Ditës Ndërkombëtare të Gruas, ZBGJ në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit organizoi një tryezë me pjesëmarrjen e këshilltareve komunale, nënave dhe grave të dëshmorëve, zyrtareve policore, drejtoreshave të shkollave, punonjëseve komunale dhe OJQ-ve. Diskutimet u fokusuan në të drejtat e grave për arsimim, punësim, fjalën e lirë dhe lëvizjen. Aktiviteti kishte një pjesëmarrje prej 69 personash, ndër të cilët 67 gra dhe 2 burra.

Në bashkëpunim me përfaqësues të USAID dhe grupin joformal të grave u organizua takim për të diskutuar të drejtat e grave në regjistrimin e pronës. Po ashtu, në kuadër të projektit “Ju nuk jeni vetëm”, u realizua një vizitë në shoqatën e gruas “Hareja”, duke informuar gratë e moshuara për të drejtat dhe mbështetjen e ofruar nga komuna.



Në SHL-Kosova u mbajt një debat me temën “Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore”, ku të rinjtë u informuan për rolin dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për Barazi Gjinore.

Në kuadër të muajit tetor, muajt kunder kancerit të gjirit, Drejtoria e Shëndetësisë në Rahovec organizoi ligjërata në QKMF dhe tryeza diskutimi për të rritur ndërgjegjësimin për kancerin e gjirit. Aktivitetet u fokusuan në parandalimin dhe kujdesin për shëndetin e grave, veçanërisht në zonat rurale.

Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit në bashkëpunim me shoqatën “Hareja” dhe grupin joformal të grave, ZBGJ organizoi një tryezë të rumbullakët me temën “Dhuna në familje, dhuna në baza gjinore dhe dhuna ndaj gruas”. Pjesëmarrësit përfshinin përfaqësues nga OSBE, prokuroria dhe institucionet e sigurisë në Gjakovë, Rahovec dhe Malishevë. Tryeza shërbeu për të identifikuar hapat drejt formimit të Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës në Familje, i cili pritet të realizohet në vitin 2024 me përkrahjen e OSBE-së.

Zyrtari për Barazi Gjinore në Komunën e Kaçanikut: ka prezantuar një raport të detajuar për aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023, duke kontribuar në fuqizimin ekonomik dhe mirëqenien e grave, si dhe në ngritjen e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore.

Në kuadër të shënimit të 8 Marsit, ZBGJ organizoi pesë ditë aktivitetesh sensibilizuese në të gjitha shkollat e komunës, duke mbajtur ligjërata me temën “Roli i gruas në shoqërinë kosovare dhe sfidat e saj”. Aktivitetet përfshinë vetëdijësimin e nxënësve për çështjet gjinore, si dhe një defilim simbolik në qytet me pjesëmarrjen e zyrtarëve institucionalë dhe grave asambleiste.

Gjatë vitit u mbajtën trajnime dhe debate të organizuara nga organizata të ndryshme, përfshirë OSBE, USAID, Helvetas dhe Agjencinë për Barazi Gjinore. Këto aktivitete kishin për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe shkëmbimin e përvojave për promovimin e barazisë gjinore.

Në grupin e performancës së Komunës, ZBGJ kontribuoi në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga aspekti gjinor për raportimin e vitit paraprak. Përkushtimi institucional u konkretizua me fitimin e një granti të performancës.

Mekanizmi Koordinues për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje organizoi katër takime me anëtarët e mekanizmit kundër dhunës në familje. Diskutimet u fokusuan në raportimin e rasteve, monitorimin e tyre dhe marrjen e masave të duhura në rastet e dhunës në familje.

Fushata Kundër Kancerit të Gjirit u organizua në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe QKMF-në, u mbajtën aktivitete vetëdijësuese, shpërndarje broshurash dhe vendosje simbolike e kordelës rozë. Aparati i mamografisë qëndroi pesë ditë në qytet, duke mundësuar testimin e 60 grave. Gjithashtu, u organizuan tri tryeza për fuqizimin e grave në shoqëri dhe vendimmarrje.

Në fshatin Begrac u mbajt një takim me 25 gra, ku u diskutua për pjesëmarrjen e tyre në trashëgimi dhe ndarjen e pronës.

Në aktivitete të ndryshme për ndarjen e granteve dhe subvencioneve morën pjesë 30 gra. Po ashtu, 35 gra me biznese të veta u përfshinë në iniciativë për zhvillimin dhe fuqizimin e bizneseve të tyre.

Aktivitetet që u realizuan në kuadër të 16 Ditëve të aktivizmit, ishin vendosjen e sloganeve sensibilizuese në hyrje dhe dalje të qytetit me mesazhin “Dhuna është krim – raporto!”.

Ligjërata në të gjitha xhamitë e komunës, të mbajtura nga Bashkësia Islame dhe sektori i gruas, me pjesëmarrjen e 40 grave. Tryezë e rrumbullakët me temën “Dhuna në familje dhe baza gjinore”, ku morën pjesë 60 gra.

MANDATI I AGJENCISË PËR BARAZI GJINORE

Mandati, detyrat, dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Barazi Gjinore janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore. Agjencia për Barazi Gjinore është organ i rëndësishëm për funksionimin e institucioneve demokratike dhe ka mandat të hartojë, të zbatojë, të propozojë, të koordinojë dhe të monitorojë politika publike vendore dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe është përgjegjëse për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, në Kosovë

Adresa: Agjencia për Barazi Gjinore/ Zyra e Kryeministrit,
Sheshi Skënderbe kati VII, Prishtinë, 10000
Tel: +381 38 200 14 276 E-mail: info.abgj@rks-gov.net
Vizitoni web faqen e ABGJ-së <http://abgj.rks-gov.net>